




JAN TECHAU

**Siguria
europiane
pas Ukraines**



IAN BURUMA

**Shtypur
ne emer
te lirise**



SHADY HAMADY

**Letra ime
drejtuar nje
perendimori**

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al-Shkurt 2015

ANALIZA E DER SPIEGEL: Ja planet e
emergjencës të europianëve, nëse ndodh largimi

GREXIT - Dilema e madhe e Europës



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



“GREXIT”-Ç’ndodh nëse Greqia del nga Eurozona?

ANALIZA NGA “DER SPIEGEL”

Bankat në të gjithë Evropën, duke përfshirë Bankën Qëndrore Evropiane, po përgatiten mbi mundësinë që Greqia të lërë eurozonën. Me Athinën dhe Brukselin ende në mosmarrëveshje, një skenar i tillë duket më real se kurrë. Por sa përçarëse, do të ishte në të vërtetë kjo ngjarje?

Të mërkurën e javës së dytë të shkurtit, 30 menaxherët kryesorë në një bankë të madhe gjermane, morën një e-mail në të njëjtën kohë. Pak kohë më vonë, telefonat e tyre ranë thujse njëkohësisht me një zë të automatizuar, që u jepte të gjitha fjalëkalimet, dhe një numër për të telefonuar saktësisht në orën 8.30 dhe bashkuar një telekonferencë me bordin e drejtorëve.

Ky komunikim i ethshëm, ishte hapi fillestar i planit të emergjencës, një strategji e paraqitur në një dokument prej dhjetëra faqesh, që përmban në detaje mënyrën sesi menaxherët, duhet të reagojnë në rast se Greqia lë eurozonën. Pas ndarjes fillestare të informacionit, ky i fundit i kalon bordit mbikëqyrës dhe zyrtarëve

publikë të financave gjermane.

Plani përfshin ndërkohë, edhe kontaktet me investitorët e mëdhenj. Pyetjet, kanë të bëjnë me humbjet e mundshme të bankave. Reagimi shtrihet edhe në komunikimin e brendshëm të bankës, me udhëzime për punonjësit, për të menaxhuar situatën e re. Konsumatorët dhe pronarët e aksioneve gjithashtu, duhet të mbahen të informuar. Saktësisht në orën 18.00 ku mbaroi edhe dita e punës, “kriza” morri fund.

Skenare të tilla, po praktikohen në të gjithë Evropën ditët e fundit. Të enjten e shkuar, qeveria e re greke e kryeministrit Aleksis Cipras, më në fund aplikoi për një zgjatje të programit të saj të shpëtimit. Por, nga perspektiva e ministrit gjerman të Financave Wolfgang Shojble, Athina nuk arriti të përmbushë kushtet e përcaktuara nga eurozona. Pra edhe nëse një kompromis u arrit në fund, loja e e nivelit të lartë e pokerit nuk ka përfunduar.

Larg nga të qëniet e thjeshtë

Kreditorët e Greqisë, tashmë të njohur si “institucionet” në vend të “trojkës”, nuk duhet të arrijnë një marrëveshje vetëm mbi normën e interesit dhe periudhën e pagesës, por edhe për çështje të tilla si paga minimale dhe rritja e përfitimeve të atyre, që kanë dalë në pension. Nga njëra anë, janë mbështetësit e krahut të majtë të partisë populiste së Ciprasit “Syriza”, shumë prej të cilëve jetojnë ende në botën e viteve '70, në epokës së partive të përçara komuniste.

Në anën tjetër, ndodhen 18 ministrat e financave eurozonës, që janë bashkuar për të siluruar premtimet e Ciprasit gjatë fushatës zgjedhore. “Syriza”, dëshiron të rrisë shpenzimet publike, ndërsa euro grupi kërkon reduktimin e tyre. Athina planifikon të rrisë numrin e nëpunësve civilë, ndërsa Brukseli beson se shpenzimet publike, duhet të ulen më tej.

Euro grupi beson se privatizimi i aseteve, që zotërohen nga shteti duhet të jetë një prioritet, ndërsa qeveria Cipras tani për tani, e ka pezulluar këtë proces. Pra klima është tejet helmuese. Suksesi do të varet kryesisht nga lëshimet, që do të bëjë Ciprasi. Për të qenë të sigurtë, atij duhet t'i jepet një lehtësim i normës së interesit, ose të lejohet të përmirësojë kushtet sociale në Greqi.

Ndërkohë Cipras, duhet të bjerë dakord për vijimin e planit të kursimit. Dhe kjo do të ishte saktësisht e kundërta, e asaj që ai u premtoi qytetarëve grekë gjatë fushatës zgjedhore. Opsioni tjetër i vetëm, mbetet largimi i Greqisë nga eurozona. Banka Qendrore Evropiane gjithashtu, po përgatitet për një skenar të tillë. Madje zyrtarët e BQE-së, po kërkojnë nga Athina të kontrollojë flukset e kapitalit, në kushtet kur dyshohet se çdo ditë grekët po dërgojnë jashtë vendit më shumë se 1 miliardë euro.

Selia qendrore e Syriza-s

Në selinë qendrore të Syriza-s në sheshin Kumunduru në Athinë, udhëheqjen e partisë nuk e gjetëm, pasi ndodhej në parlament, për zgjedhjen e presidentit të ri. Por funksionarët e nivelit të dytë dhe të tretë, ishin aty, duke shprehur mosbesim ndaj BE. “Gjermanët dhe elita evropiane, duan të na merret fryma. Përse? Për shkak se ata duan, që Greqia të bëhet një shembull në këtë drejtim”- thotë 61-vjeçari Alekos Kalivis, një anëtar i byrosë politike të partisë.

Çfarë do të ndodhë, nëse Brukseli nuk i bindet kërkesave të Athinës? “Ata duhet të binden, përndryshe do të ishte sikur zgjedhjet të mos kishin ndodhur. Në çdo rast ne s'mund të pranojmë asnjë zgjidhje, që na kërkon të braktisim parimet tona”- shton ai. Ndërkohë Vasilios Primikiris, një mjek anestezist 63-vjeçar, anëtar i Komitetit Drejtues, shprehet se Syriza është e dënuar të ketë sukses, dhe këmbëngul se qeveria Cipras ka ende ndikim në Evropë.

“Një dalje e Greqisë nga eurozona, do të ishte zgjidhja më e shtrenjtë për të gjithë”- thotë ai. Pastaj- vazhdon ai- peshkaqenët do të fillojnë kërkimin për gjah të freskët në vende si Italia apo Spanja. “Zonja Merkel është varmihësja e Evropës”- thotë Primikiris.

Historia e suksesit në Letoni

Valdis Dombrovskis, nënkryetar i ri i Komisionit Evropian, është një fizikan i njohur, që ka fituar në Bruksel reputacionin e një politikani, që flet vetëm kur ka diçka për të thënë. Për më tepër, 43-vjeçari nga Letonia, e di sesi duhet të “lundrojë” një vend përmes vështirësish financiare.

Kur shteti balltik, u përfshi nga kriza financiare në vitin 2009, Dombrovskis ishte kryeministër i vendit. Ai reduktoi menjëherë numrin e nëpunësve civilë me 30 përqind, dhe uli me 40 përqind pagat e atyre, që mbetën në punë. Dy vite më vonë, ekonomia letoneze filloi sërish të rritej. “Bindni tregjet financiare, se jeni seriozë mbi reformat dhe keni rivendosur stabilitetin financiar”-tha ai për BBC-në në vitin 2011, duke shpjeguar historinë e sukseshshme të Letonisë.

Tashmë që Dombrovskis është Komisioneri i ri për Euron dhe Dialogun Social, ka një qasje të rreptë ndaj mosmarrëveshjeve mbi borxhin e Greqinë. Ai nuk i kupton realisht grekët. Para zgjedhjeve të janarit, gjendja në vend ishte përmirësuar. Asokohe Athina, kishte më shumë shanse për marrjen e ndihmave të reja nga Brukseli, çka do të krijonte një hapësirë më të madhe manovrimi për qeverinë. Por zgjedhja e Ciprasit, ndryshoi rrënjësisht situatën. Shumë grekë ndaluan pagimin e taksave, apo paguan më pak, në pritje të shkurtimeve të tyre, sipas premtimeve të bëra gjatë fushatës. Ndërkohë, nga frika e qeverisë së majtë, kompanitë shkurtuan investimet. Rezultati tani është se vrima në buxhetin kombëtar, është me e madhe sesa ishte më parë.

”Tanimë s’ka asnjë alternativë tjetër për grekët, përveçse të aplikojnë për një program të ri gjithëpërfshirës të shpëtimit”-thotë një burim në Bruksel. Negociatat e ardhshme-vijon burimi- mes euro grupit dhe Athinës “do të jenë më të ashpra se çdo gjë tjetër që kemi parë deri tani”.

Fatura e mundshme e “Grexit”

Nëse Greqia do të dalë nga eurozona, qeveria do të duhet të qarkullojnë brenda natës një monedhë të re, e cila në mënyrë të menjëhershme, do të zhvlerësohej ndaj euros. Të paktën në fillim, do të ketë një kaos të vërtetë. Bankat, do të funksionojnë përmes lëkundjesh të rrezikshme, normat e interesit do të rriten shpejt, dhe kompanitë do të falimentonin.

“Numri i falimentimeve do të rritej me 50 përqind që këtë vit, me një shtesë prej 30 përqind për vitin e ardhshëm”- parashikon Ludovik Subran, ekonomisti kryesor tek agjensia e sigurimit të kredive “Euler Hermes”. Ndërkaq agjensia e ndërkombëtare e rejtingut “Standard & Poor’s”, mendon se edhe kompania më e madhe shtetërore e shërbimeve të energjisë elektrike, ka të ngjarë të shkojë drejt falimentit.

Për të parandaluar, që njerëzit të mënyjnë nëpër banka, Greqia duhet të aplikojë përkohësisht kontrollet mbi flukset e parave. Transferrat jashtë vendit do të ndalohen, do të vendosen kufij për tërheqjen e shumave nga banka, dhe kontratat e furnizimit do të pezullohen. Ka të ngjarë, që edhe ilaçet apo produktet ushqimore të huaja, të gjenden vetëm tek tregu i zi dhe do të mund të blihen, vetëm me një monedhë të fortë.

Analistët e bankës gjermane “Commerzbank”, besojnë se një rrjedhojë e mundshme e zhvlerësimit të monedhës kombëtare, do të ishte që borxhi i qeverisë greke do të rritej, nga niveli i tanishëm prej 175 përqind e Prodhimit të Brendshëm Bruto, në 230 përqind. Athina s’do ishte më në gjendje të paguante këstet e borxhit. Është akoma më e vështirë, të parashikohet sesi do të reagonin njerëzit, ndaj një situatë të tillë. Shpallja e falimentit nga Argjentina në vitin 2001, u pasua nga trazira të dhunshme dhe grabitje masive. Një shembull i tillë gjithashtu, na tregon sesa shumë kohë, mund t’i duhet një ekonomie, për t’a rimarrë veten nga një krizë si kjo.

Dhjetëra mijëra argjentinës, shumë prej tyre të mirëarsimuar, braktisën vendin e tyre, dhe shumë grekë do të bënin të njëjtën gjë. Gjithashtu besimi i investitorëve

ndërkombëtarë do të lëkundej. Ka mundësi, që qeveria greke të ketë vështirësi, për të grumbulluar para në vitet që do të vijnë.

Mundësi për Greqinë ?

Në të njëjtën kohë, një monedhë e re më e lirë, do të krijonte disa mundësi. Ajo papritmas, do t'i bënte eksportet greke, shumë më të lira. Hans-Verner Sin, president i një think-tanku ekonomik në Mynih, beson se për shembull vendi mund të ringjallë industrinë tekstile, që u zhduk disa vite më parë.

Ndërkohë, vendi do të bëhet më i lirë për të kaluar pushimet. Aktualisht, shumë destinacione turistike në Greqi vuajnë, pasi çmimet janë më të lira në Turqi, ku qiejt dhe detet janë po aq blu sa në vendin fqinj. “Në veçanti, industria greke e turizmit do të përfitonte fuqimisht nga një Grexit”- thotë Tomas Majer, që më parë ka shërbyer si ekonomist kryesor në “Deutsche Bank”.

Çështja këtu ka të bëjë me shkallën e stimulit, që kjo ngjarje do të siguronte mbi eksportet dhe sektorin e turizmit. Më e rëndësishme akoma, është çështja se kur do të fillojë bumi. Por Instituti Kiel për Ekonominë Botërore, dyshon nëse Greqia në një periudhë afatgjatë, do të përfitonte nga rifutja e dhrahmisë.

“Një zhvlerësim i ngadaltë, nuk do të bëjë absolutisht asgjë, për të ndryshuar problemet strukturore të Greqisë”- thotë Stefan Kots, kreu i qendrës së parashikimit në institut. Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ka një pikëpamje të ngjashme mbi këtë skenar. Burimet nga FMN-ja në Uashington, thonë se kostoja e daljes nga euro, do të jetë më e madhe për Greqinë, sesa po të vazhdojë me programin e reformave në gjirin e euros.

Por ndryshimi i monedhës, do të mund të sigurojë një avantazh të rëndësishëm për qeverinë greke. Kjo e fundit, mund të shtypë aq shumë para sa i nevojiten, për të financuar premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore.

MARRË ME SHKURTIME NGA “DER SPIEGEL”



Çfarë i detyrohet Gjermania Greqisë

NGA CLIVE CROOK

Qeveria gjermane ka treguar pak respekt për qytetarët grekë. Por a nuk është ana tjetër e bashkimit të sovranitetit, që udhëheqësit e Gjermanisë duhet të kenë për detyrë të kujdesen dhe respektojnë, ndaj jo-gjermanëve? Vendet që nuk ndihen rehat me këtë kërkesë, ndoshta duhet të mendohen dy herë për ndërtimin – atëherë shumë të zgjeruar – të Bashkimit Evropian

Sa rëndësi ka nëse kërkesa e Greqisë, për një program të ri të shpëtimit me kushte më të buta, u kërkua me ngulm nga një qeveri e re, e zgjedhur pikërisht falë këtij premtimi, një qeveri që ruan një mbështetje të fortë edhe kur propozimet e saj refuzohen nga pjesa tjetër e Bashkimit Evropian? Sa rëndësi ka demokracia në një situatë si kjo?

Në një artikull për “Project Syndicate” në fillim të këtij muaji, Jozeph Stiglitz, laureat i çmimit Nobel dhe profesor i ekonomisë në Universitetin amerikan të Kolumbias, shkruante se është demokracia ajo që ka më tepër rëndësi. Nëse Evropa i thotë jo kërkesës së votuesve grekë për një ndryshim të kursit, ajo po kumton se demokracia është diçka pa rëndësi, të paktën kur është fjala për ekonominë. Ekonomistët e tjerë nuk u pajtuan me një konstatim të tillë. Votuesit grekë, mund të duan ristrukturimin e borxhit të tyre dhe uljen e taksave. Por çdo të bëhet me votuesit në Gjermani dhe pjesën tjetër të eurozonës? Edhe mendimet e tyre kanë shumë rëndësi. Nëse demokracia ka rëndësi, ndoshta duhet të vendosë shumica e

njerëzve në gjirin e BE.

Jakob Funk Kirkegard i institutit "Peterson", bie dakord me këtë gjë. Ai madje shkon edhe më tej, kur deklaron se grumbullimi i sovranitetit ekonomik brenda eurozonës, nuk është në përputhje me nocionin e një mandati parësor kombëtar. Është jorealiste për Greqinë të pretendojë se votuesit e saj kanë atu-në në raport me votuesit në vendet e tjera.

Në të vërtetë, brenda një bashkimi monetar, ku asnjë anëtar nuk është plotësisht sovran, është natyrshëm e pamundur për çdo qeveri të zgjedhur rishtas, të pretendojë se mandati i saj zgjedhor është mbi gjithçka tjetër. Edhe një gjë tjetër: planet faktikë (në krahasim me zgjedhjet politike), nuk e japin hua veten e tyre që të gjykohen nga votimi popullor. Për shembull, kërkesat matematikore mbi aftësinë paguese kombëtare nuk mund të shfuqizohen, për shkak se votuesit e një vendi nuk i pëlqejnë ato.

Të votosh që hëna është e përbërë prej djathit nuk do ta bëjë atë të tillë. Të gjitha kundërshtimet mbi komentin e Stiglitz janë të sakta. Pjesa tjetër e zonës së euros është brenda të drejtës së saj, për t'i thënë jo Greqisë, dhe kjo nuk do të përbënte një hedhje poshtë të parimeve demokratike.

Por edhe në këtë rast na shpëton një detaj i rëndësishëm: kërkesa minimale për një demokraci që funksionon mire është ajo ku udhëheqësit e saj respektojnë njerëzit që ata përfaqësojnë. Supozoni për një moment se kërkesat e Greqisë janë të paarsyeshme, ose të pamundura për t'u plotësuar, kështu që ka kuptim për vendet e tjera të thonë jo. Në këtë rast, mënyra e refuzimit ka ende rëndësi.

Një refuzim i bazuar do ishte në fakt një hedhje poshtë e parimeve demokratike, nëse ajo do të shprehte përbuzje për votuesit grekë. Dhe në të vërtetë kjo është ajo që kemi parë. Qeveria gjermane ka treguar pak respekt për qytetarët grekë.

Por a nuk është ana tjetër e bashkimit të sovranitetit, që udhëheqësit e Gjermanisë duhet të kenë për detyrë të kujdesen dhe respektojnë, ndaj jo-gjermanëve? Vendet që nuk ndihen rehat me këtë kërkesë, ndoshta duhet të mendohen dy herë për ndërtimin – atëherë shumë të zgjeruar – të Bashkimit Evropian. Elektorati në të gjithë BE-në është ngopur me zhvillimin e sistemit të përbashkët të qeverisjes. Ngulitja e kësaj ideje do të jetë e vështirë dhe mund të kërkojë forcimin linjës së përgjegjësisë së qeverive kombëtare ndaj zgjedhësve të tyre.

Megjithatë, në një BE të mirë-drejtuar, qeveritë që veprojnë në harmoni me njëra-tjetrën do të përpiqen të përfaqësojnë interesat kolektive të të gjithë qytetarëve të unionit. Përndryshe, cili mbetet thelbi? Përgjigja kolektive e Evropës ndaj gjendjes së tmerrshme ekonomike të Greqisë ka qenë mospërfillëse, madje ndëshkuese.

Duke hedhur poshtë protestat e votuesve grekë, minohet ideja se bashkimi duhet të mbijetojë dhe shpëtojë. Sikurse po ndodh, propozimet e Greqisë janë kryesisht të arsyeshme. Pranimi i shumicës prej tyre, do t'i shërbente në fakt interesave më të gjera ekonomike të Evropës.

Por edhe nëse nuk do të ndodhte kështu, dhe të rezultonte se Gjermania e mbështetësit e saj kishin të drejtë mbi qëndrimin që mbajtën, refuzimi i tyre duhet të pastrohet nga përbuzja për një komb që tashmë është duke vuajtur në mënyrë të pazakontë, dhe që thjesht po i kërkohet të vuajë disi më shumë. /"Bloomberg"/



Zgjedhjet e vështira përpara Europës

CHRIS MORRIS

Ngado që të kthehesh, Gjermania duket se merr rolin udhëheqës në Europë për momentin. Dhe Kancelarja Merkel qëndron mbi të gjithë të tjerët si personaliteti dominues politik i këtij kontinenti

Ky i fundit ishte një samit zyrtarisht joformal, por që erdhi në një moment shumë dramatik. Si i tillë, ai u mor me ata që konsiderohen si dy problemet më të mëdhenj që do të hasë Europa në vitet e ardhshëm. Pikësëpari, ka dilema sociale dhe ekonomike që lidhen me eurozonën, masat e kursimit dhe çështjen shqetësuese të rritjes ekonomike. Greqia ka qenë gjithmonë në anën e mprehtë të këtij debati, edhe pse për shkak të përmasës relativisht të vogël të ekonomisë së saj, mund të mos përbëjë rrezikun më afatgjatë.

Por zgjedhja e Alexis Tsiprasit dhe Syrizas i ka sjellë gjërat mbi tryezë, dhe si pasojë deri në fund të shkurtit do të duhet të merren vendime të mëdhenj.

Tsiprasi po sfidon rendin e vendosur ekonomik në eurozonë, dhe ai ka një sërë forcash të cilat janë reshtuar kundër tij. Sidoqoftë, kompromisi duket gjithmonë e më i mundshëm: një zgjidhje semantike që do të arrijë të kënaqë të dyja palët. Diskutimet teknike po fillojnë, por vendimet përfundimtare do të jenë, në fund të ditës, politikë.

Asgjë nuk është e garantuar, dhe Syriza duket e përgatitur për të çuar gjërat deri në skaje, me qëllim që të përmbushë sa më shumë prej atyre premtimeve që u ka bërë votuesve, që të jetë e mundur. Por Tsiprasi mund të marrë zemër prej faktit që askush nuk dëshiron ta humbasë Greqinë, sidomos në një kohë kur problemi i dytë i madh me të cilin përballet Europa është kaq shumë delikat.

E ardhmja e Ukrainës është bërë tashmë një prej sfidave më të mëdha të sigurisë të kohës sonë, si dhe rreziku më i madh për marrëdhëniet Lindje-Perëndim, që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Cfarë qasje duhet të zgjedhë Europa kundrejt kufijve të saj lindorë, dhe çfarë lloj marrëdhënieje duhet të vendosë BE me Rusinë e Vladimir Putinin?

Fokusi tashmë do të jetë mbi monitorimin e mënyrës se si po zbatohet marrëveshja më e fundit e armëpushimit që u arrit në Minsk. Në sfond vjen rrotull kërcënimi i vazhdimit dhe ndoshta edhe shtimit të sanksioneve.

Ka një çështje të tretë të madhe me të cilën BE do të duhet të merret së afërmi, dhe kjo është pa dyshim marrëdhënia e Britanisë me pjesën tjetër të Europës, si dhe pyetja nëse një prej shteteve më të mëdhenj të BE do të duhet të largohet. Për momentin është lënë pas dore, deri pas daljes në maj të rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme në Mbretërinë e Bashkuar. Por menjëherë pas zgjedhjeve, dalja e Britanisë mund të kërkojë vëmendjen e debatit të BE-së.

Dhe ka diçka që i lidh të tre këto sfida – Greqinë dhe eurozonën; Ukrainën dhe Rusinë; si dhe mundësinë e daljes së Britanisë nga BE. Madje është jo diçka që i bashkon, por dikush: Angela Merkel.

Eshtë në qendër të skenës në debatin për Greqinë dhe masat e shtrëngimit, me ripohimin e pozicionit të Gjermanisë si fuqia ekonomike kryesore e Europës.

Ishte në qendër të skenës në bisedimet e Minskut, pasi ka kaluar shumë më tepër kohë me Vladimir Putinin gjatë vitit të fundit, se sa çdo udhëheqës tjetër perëndimor.

Dhe është në qendër të skenës si e vetmja udhëheqësve që një qeveri e ardhshme britanike – e cilëso ngjyrë – do të dojë të ketë në krah, nëse do të dojë të ndryshojë marrëdhënien me BE-në.

Kështu që, nga do që të kthehesh, Gjermania duket se merr rolin udhëheqës në Europë për momentin. Dhe Kancelarja Merkel qëndron mbi të gjithë të tjerët si personaliteti dominues politik i këtij kontinenti. /BBC/



Dilema që nuk është...

FINANCIAL TIMES

Evropa nuk duhet të ketë dyshime mbi mundësinë për të provuar lartësinë e idealeve të saj

Udhëheqësit evropianë kanë shumë arsye për t'u shqetësuar, që nga brishtësia e monedhës së tyre të përbashkët, deri tek kërcënimet xhihadiste dhe ambiciet e Ruisë. Çfarë ata nuk kanë problem është mbipopullimi. Evropa mund të jetë kontinenti i vetëm, ku numri i vdekjeve ka tejkaluar atë të lindjeve. Dhe pavarësisht afërsisë së madhe të kontinentit të vjetër me Lindjen e Mesme dhe Afrikën, vetëm një evropian në dhjetë ka lindur jashtë Bashkimit Evropian. Por Evropa është aq e rrethuar nga frika e të qenit e pushtuar nga emigrantët, saqë është duke i lënë me mijëra të vdesin në Detin Mesdhe. Në tetor të 2014-ës, ndonëse atë vit u mbytën tre mijë emigrantë, Komisioni Evropian e mbështeti Italinë në vendimin për të ridimensionuar operacionin MARE Nostrum, i cili kishte shpëtuar mijëra jetë. Misioni u nis nga Italia pas tragjedisë së Lampedusa-s, ku, më 3 tetor 2013 vdiqën 366 emigrantë. "Triton", operacioni i Bashkimit Evropian i cili zëvendësoi MARE Nostrum, mund të ndihmojë vetëm varka të ngarkuara me refugjatë, që gjenden brenda 30 milje larg nga bregu. "Triton" kushton një të tretën e Mare Nostrum, por kjo nuk e justifikon vendimin e Komisionit. 75

milione euro diferencë, janë shumë pak po të kesh parasysh buxhetin evropian. Edhe më domethënës është fakti se një operacion që është përdorur për të shpëtuar jetë njerëzore, tashmë është zëvendësuar nga një program i cili menaxhohet nga agjencia Frontex, në krye të patrullimit të kufijve të jashtëm të shteteve të BE. Duket se politikanët evropianë janë më të shqetësuar për t'i dekurajuar emigrantët, në vend që të shmangin vdekjen e tyre. Disa argumentojnë se do të ishte më humane që të eliminoheshin operacionet e shpëtimit, pasi ata nxisin trafikantët për të ngarkuar edhe më shumë njerëz në anijet e tyre.

Numrin në rritje të migrantëve e shkaktojnë krizat humanitare, jo iluzioni i një kalimi më të lehtë. Të ballafaquar me perspektivën e torturës, sëmundjeve dhe vdekjes, llogaritja e probabilitetit për t'ia dalë mbanë dhe kaluar Mesdheun, ka shumë pak ndikim në vendimin për t'ia mbathur. Komisioneri i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara, Antonio Gutierres me të drejtë ka thënë se këta njerëz janë të shtyrë nga dëshpërimi dhe shpresa. Në dritën e gjithë këtyre detajeve, prioriteti evropian duhet të jetë shpëtimi i emigrantëve në rrezik. Duhet rikthyer operacioni Mare nostrum, por këtë herë nën përgjegjësinë e Bashkimit Evropian.

Në lartësinë e një ideali

Vende të tilla si Italia dhe Greqia kanë nevojë të mbështeten dhe partnerët evropianë duhet të angazhohen për të pranuar më shumë refugjatë. Për më tepër, vendet e origjinës së emigrantëve duhet të ndihmohen për të identifikuar dhe ndëshkuar trafikantët.

Luksi i migrimit do të ulet vetëm kur konfliktet të shuhen në Mesdhe. Evropa nuk mund të bëjë shumë për të shpejtuar këtë proces, por ajo mund të zvogëlojë koston në jetë njerëzore. Sidomos të trajtohen refugjatët si viktima dhe jo si një kërcënim. Ardhja e të rinjve nga vendet e tjera do të mund të zgjidhte krizën demografike të kontinentit. Problemi i emigrantëve është përshkruar si një dilemë e madhe. Por ajo nuk ekziston. Respekti që Evropa ka për të drejtat e njeriut pjesërisht shpjegon pse janë të shumtë ata që kërkojnë strehë brenda kufijve të saj. Evropa nuk duhet të ketë dyshime mbi mundësinë për të provuar lartësinë e idealeve të saj.



Siguria evropiane pas Ukrainës

NGA JAN TECHAU*

Në kundërshtim me atë që thonë shumë analistë, ajo krizë ka shumë pak lidhje me rregullat, arkitekturën, dhe të gjitha abstraksionet e tjera, që mbushin shumicën e komenteve. Ka të bëjë me shumë me atë, se kush është më i gatshëm të vërë në dispozicion fuqinë ushtarake për të mbrojtur Europën Perëndimore dhe Qëndrore. Me fjalë të tjera, kriza ukrainase ka të bëjë me rolin e Shteteve të Bashkuara në Evropë

A ka realisht një përçarje strategjike, midis Shteteve të Bashkuara dhe Evropës? Nëse ju e besoni jehonën e mediave, që kumbonte ende në unison pas Konferencës të Sigurisë në Myhij, një takim i përvitshëm i liderëve dhe ekspertëve të mbrojtjes, përgjigja është po. Çështja nëse Perëndimi duhet të furnizojë me armë qeverinë e Ukrainës, për të mbështetur betejën e saj kundër separatistëve rusë të mbështetur nga Moska, u shndërrua në një psikozë në Mynih, por edhe gjetkë. Në fakt, përgjigja nëse ka apo jo një përçarje transatlantike mbi këtë çështje, është edhe më e komplikuar, por po aq edhe më shqetësuese. Sepse problemi i vër-

tetë nuk është Ukraina. Përkundrazi, luhet diçka shumë më e madhe. Kriza mbi Ukrainën dhe në Ukrainë është e vërtetë, sikundër sugjerojnë shumë komentues, për të ardhmen e rendit politik dhe të sigurisë në Evropë.

Por në kundërshtim me atë që thonë shumë analistë, ajo krizë ka shumë pak lidhje me rregullat, arkitekturën, dhe të gjitha abstraksionet e tjera, që mbushin shumicën e komenteve.

Ka të bëjë me shumë me atë, se kush është më i gatshëm të vërë në dispozicion fuqinë ushtarake për të mbrojtur Europën Perëndimore dhe Qëndrore. Me fjalë të tjera, kriza ukrainase ka të bëjë me rolin e Shteteve të Bashkuara në Evropë. Në thelb, evropianët dhe amerikanët janë në mes të negociatave, se cili duhet të jetë përgjegjës për sigurinë në Evropë, në kohën e mungesës së një strategjie konkrete.

Shtetet e Bashkuara duhet dhe duan të ndryshojnë drejtimin e saj gjeopolitik në paqësor, ku një rival i vështirë është në ngjitje, dhe ku e ardhmja e balancës globale të pushtetit, do të vendoset gjatë gjeneratave të ardhshme. Për krahasim “teatri” evropian mendohet se do të kërkojë më pak vëmendje.

Në teori, vendet e pasura të kontinentit të vjetër, duhet të jenë krejtësisht të afta të kujdesen vetë për sigurinë e tyre.

Kjo është veçanërisht e vërtetë, qëkur kërcënimi më i madh në Evropë vjen prej Rusisë, gjigandja lindore në rënie, që mezi është e aftë të sigurojë mbijetesën e saj ekonomike, si dhe të kontrollojë sjelljen e agresive. Por Evropa është larg nga garantimi i sigurisë, duke u mbështetur tek vetja.

Në fakt, në vend se të bëhen më të pavarura, qeveritë e saj po e rrisin varësinë e tyre nga shërbimet e sigurisë së SHBA-së, duke e ulur në mënyrë të vazhdueshme aftësinë e tyre. Kjo pjesërisht shkaktohet nga kriza ekonomike, e pjesërisht për shkak të paaftësisë akute që sjell mospasja e një strategjie. Evropianët duken se janë të pavetëdijshëm për dilemën e tyre strategjike: se Shtetet e Bashkuara duhet të përqendrohen në vende të tjera, ndërsa siguria e Evropës është gjithnjë e më e kërcënuar nga fqinjët e saj të padisiplinuar.

Kriza e Ukrainës, vetëm sa ka përshpejtuar negociatat ndërmjet vetë Perëndimit, mbi sistemin e ri të sigurisë në Evropë. Çuditërisht, përçarja aktuale mbi vetë Ukrainën, është shumë më e vogël sesa duket. Kur kriza u bë serioze, Shtetet e Bashkuara dhe Evropa vepruan me të drejtë në sinkron mes tyre.

Përgjigja e tyre ishte një përzierje e sigurive të dhëna nga NATO me vendosjen e sanksioneve kundër Rusisë, si dhe mbështetjen ndaj qeverisë së re në Kiev. Megjithatë, më e rëndësishme është që Perëndimi (me të drejtë) vendosi më herët sesa duhej mbi krizën, duke u shprehur se nuk ishte i gatshëm të shkonte në luftë për Ukrainën.

Duke vepruar kështu, liderët perëndimorë e bënë të qartë se garancitë e tyre të sigurisë nuk zbatohen dot në rastin e Ukrainës dhe se vendi nuk ishte pjesë e arkitekturës së sigurisë evropiane. Kjo është vërtetë tragjike për ata ukrainas që u bënë pjesë e tubimeve masive në Sheshin e Pavarësisë në Kiev, gjatë protestave kundër qeverisë në fundin e vitit 2013 dhe vitin 2014.

Por kjo ishte e vetmja rrugë përpara. Përfshirja ushtarake perëndimore do të ishte absolutisht një çmenduri. Edhe sot kjo politikë nuk ka ndryshuar. Shtetet e Bashkuara dhe Evropa ndodhen në të vërtetë në të njëjtën linjë. Të kalojmë tani tek përçarja, që vjen nga diskutimi rreth furnizimit me armë të Ukrainës. Zhurma që “skifterët” e Uashingtonit bënë në Konferencën e Sigurisë në Mynih mbi këtë çështje – mjafton vetëm të dëgjohet fjalimi i ashpër zemërak i senatorit amerikan Xhon Mekein kundër “diplomacisë budallaqe” të kancelares gjermane Angela Merkel – i drejtohej më pak evropianëve dhe më shumë presidentit të tyre Barak Obama dhe ekipit të këtij të fundit, të cilin kundërshtarët e brendshëm e akuzojnë se është shumë i butë.

Në një nivel më bazik, kjo potere reflektoi edhe një pakënaqësi të vërtetë që

SHBA ka ndaj mosgatishmërisë së evropianëve për të kuptuar dilemën themelore strategjike me të cilën ata përballen. Në rastin e Ukrainës, Mekein mundet të “lehë” tek “pema e gabuar”, por ai vë theksin edhe tek një pikë e rëndësishme, kur kërkon nga evropianët të bëjnë më shumë për sigurinë e tyre. Cili do të jetë rezultati i negociatave mbi sigurinë evropiane, në botën post-evropiane? Nuk është e qartë, dhe për më tepër deri tani nuk është gjetur një zgjidhje e qëndrueshme.

Tani për tani, Amerika është rikthyer, megjithëse pa dëshirë. Me angazhimin e përtërirë të SHBA-së, NATO ka përforcuar krahun e vet lindor, duke shënuar kufijtë, jashtë të cilave përgjegjësitë e sigurisë së Perëndimit përfundojnë. Ukraina është lënë e varur në një pozicion të ndërmjetëm, me pjesë të territorit të saj që janë shndërruar në një tjetër konflikt të ngrirë e që siguron zgjatjen e ndikimit rus, mbi këtë pjesë të hapësirës post-sovjetike.

Ndërkohë evropianët po përpiqen dëshpërimisht të mbrojnë ekonomitë dhe sistemet e tyre politike, përherë të brishta, nga shpërbërja. A mundet kjo formë e mpakjes Perëndimore, Evropës me gjysmë zemre, si dhe një prani e përforcuar e SHBA-së në kontinentin e vjetër, të jetë e ardhmja e sigurisë evropiane?

Po, por jo për një kohë të gjatë. Vakumi i vazhdueshëm i pushtetit stimulon një këqyrje të jashtme.

Evropa duket e paaftë as të monitorojë rendin dhe as të integrojë “lagjen e saj” fqinje. Gjermania, udhëheqësja e përkohshme e Evropës, është një lojtare e strategjikisht e paplotë, ndërsa lojtarët tradicionalë dhe kryesorë të Evropës, Franca dhe Britania e Madhe, të paktën për momentin, e kanë mënjanuar veten e tyre, për shkak të dobësisë së brendshme. Në fund, të gjithë sërish do të varen nga Uashingtoni.

Pyetja vendimtare për sigurinë evropiane është nëse Shtetet e Bashkuara do të mund të priren të kontrollojnë “rrahjet e zemrës” së rendit botëror në të njëjtën kohë në Evropë dhe Azi. Negociatat e vërteta mbi sigurinë evropiane nuk janë duke u zhvilluar në Ukrainë apo në Bruksel. Ato po mbahen në Potomak.

Shënim: Jan Techau është drejtor i “Carnegie Europe”



Evropa dhe fundi i integritetit territorial të Ukrainës

NGA JUDY DEMPSEY

Evropa po hyn në një epokë të re e të rrezikshme, për të cilën ajo është tërësisht e papërgatitur

Beteja për Debaltseven është e gjatë. Më 18 shkurt, presidenti ukrainas Petro Poroshenko urdhëroi trupat e tij të tërhiqen nga qyteti, që ndodhet në rajonin e Donjeckut në Ukrainën Lindore. Ushtarët nuk kishin asnjë shans për të fituar. Ata ishin dukshëm të paktë në numër në krahasim me forcat pro-ruse, të cilat Moska i ka mbështetur gjatë gjithë konfliktit. Ndërsa ushtarët ukrainas po braktisnin qytetin e bombarduar, marrëveshja e armëpushimit e arritur në Minsk më 12 shkurt ishte thujse e rrëzuar. Thirrjet e përsëritura të kancelares gjermane Angela Merkel, ndaj presidentit rus Vladimir Putin për të zbatuar armëpushimin, ranë në vesh të shurdhër. Diplomacia dukshëm ka dështuar.

Për më tepër, evropianët nuk i kanë kuptuar mirë ndikimet që do të ketë humbja e integritetit territorial të Ukrainës. Udhëheqësit evropianë, mund të shtrëngojnë me nerv duart e veta. Ata mund të kërcënojnë të shtojnë sanksionet që aktulisht i kanë imponuar Rosisë. Por në fakt, dëmi është kryer që prej marsit të vitit të kaluar, kur Putini aneksoi Krimenë.

Me përgjigjen e saj të dobët ndaj këtij agresioni, BE-ja hodhi poshtë rregullat e epokës së pas Luftës së Ftohtë. Edhe Akti Final i Helsinkit i vitit 1975, në të cilin krerët e bllokut perëndimor dhe komunistët u zotuan të respektojnë papreks-hmërinë e kufijve, është bërë copë e çikë.

Evropa po hyn në një epokë të re e të rrezikshme, për të cilën ajo është tërësisht e papërgatitur.

Kur bëhet fjalë për përballjen me kërcënimet reale ndaj kufijve të saj lindore (sikurse e kupton këtë Rusia), evropianët ende kapen tek ideja e demonstrimit të fuqisë së butë. Por në të njëjtën kohë, disa qeveri i janë bashkuar koalicionit të udhëhequr nga SHBA për të luftuar kërcënimin terrorist, që vjen nga Shteti Islamik në Irak dhe Siri.

Ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula von der Leyen, e cila është duke përpunuar një dokument të ri strategjik që i referohet Rosisë si një kërcënim, u përpoq të shpjegojë dallimin mes qasjes ndaj agresionit rus dhe xhihadit. Duke folur në Konferencën mbi Sigurinë në Mynih, Von der Leyen tha se diplomacia nuk mund të merret vesh me Shtetin Islamik, pasi nuk ka asnjë njeri me të cilin të mund të bisedohet. Prandaj, forca është një opsion i zbatueshëm. Por ky – tha ajo – nuk është rasti i Rosisë. Atje Perëndimi ka një partner negociues.

Por mesa duket, jo më. Dështimi i marrëveshjes së fundit të armëpushimit në Ukrainën Lindore dëshmon për kotësinë e të folurit me presidentin rus. Disa udhëheqës evropianë mundet të luten që të ndryshohet strategji. Por mënyrat e tepruara me të cilat disa liderë merren vesh me Putinin, janë realisht të turpshme. Ata tallen me çështjen e unitetit evropian dhe vuajtjet e tmerrshme të civilëve në Ukrainë Lindore.

Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, që priti Putinin në Budapest në datën 18 shkurt, është i gatshëm ta bëjë vendin e tij edhe më të ndërvarur nga energjia ruse, duke rënë dakord të pranojë kreditë ruse për të ndërtuar një reaktor të ri bërthamor pranë qytetit qendror hungarez të Paksit.

Kjo varësi bart një çmim të lartë, në formën e ndërhyrjeve politike.

Deri më tani, Orban i ka mbështetur sanksionet e BE-së kundër Rosisë dhe rolin e ri të NATO-s në Evropën Lindore dhe Qëndrore. Por mbështetja e e tij vazhdueshme nuk mund të merret si diçka e mirëqenë edhe për të ardhmen. Mjerisht edhe udhëheqës të tjerë evropianë, të cilët duket se harrojnë që një luftë po zhvillohet në kufijtë e BE-së, nuk kanë dyshime të hyjnë në marrëveshje me Putinin. Presidenti i Qipros, Nikos Anastasiades do të vizitojë në datën 25 shkurt Moskën. Të mos harojmë se për shumë vite Qiproja ka qenë një strehë e sigurtë për pasuritë e oligarkëve rusë.

Kryeministri i ri grek, Aleksis Cipras, ka lënë të nënkuptohet, në një mënyrë jo aq elegante, se ai mund t'i drejtohet Rosisë për ndihma financiare nëse dështojnë bisedimet me ministrat e financave të BE-së, mbi ndryshimin e kushteve të programit të ndihmës.

Dhe mos harroni Millosh Zemanin, Presidentin e Republikës Çeke, i cili është i njohur për qëndrimin e tij pro-rus. Me udhëheqës të tillë, nuk do të ishte çudi që BE ndonjë ditë të arrijë t'i heqë sanksionet ndaj Moskës. Por ka një çështje që bart edhe më shumë rreziqe: mungesa e gatishmërisë së evropianëve për të mbrojtur integritetin territorial të Ukrainës ka vendosur një precedent.

Dikush mund të thotë se Rusia e testoi vendosmërinë e Brukselit që në vitin 2008, pasi pushtoi për një kohë të shkurtër një pjesë të Gjeorgjisë. Asokohe, përgjigja e BE-së dhe Perëndimit në përgjithësi ishte tejet e dobët. Dhe ndërsa Rusia

gjatë vitit të kaluar filloi të shkëpuste gradualisht pjesë të Ukrainës Lindore, në nëntor të vitit 2014 Kremli nënshkroi një pakt sigurie me Republikën e vetëshpallur të Abkhazisë, që Rusia e shkëputi de fakto nga Gjeorgjia gjatë luftës së shkurtër të gushtit 2008.

Me rënien e Debaltseves, Poroshenko nuk kishte asnjë mundësi tjetër përveçse të thirrte në ndihmë Kombet e Bashkuara dhe BE-në, për të dërguar trupa paqeruajtëse në Ukrainën Lindore. Ciladoqoftë përgjigja përfundimtare ndaj kësaj kërkesë, zakonisht detyra e paqeruajtësve është të ruajnë statuskuonë në terren, jo për të ndrequr ato që kanë ndodhur më herët. Një skenar ky që mund t'i përshatet Putinit.

Apeli i Poroshenkos konfirmon gjithashtu sesi BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara dështuan t'i jepnin OSBE-së personel të mjaftueshëm dhe mbështetjen e duhur për të monitoruar si duhet marrëveshjen e armëpushimit të arritur në shtator të vitit të kaluar, pas bisedimeve në Minsk.

Separatistët pro-rusë kanë bërë çdo gjë për të penguar punën e vëzhguesve të OSBE-së.

Gjithësesi, mungesa e dëshirës së evropianëve për të mbrojtur integritetin territorial të Ukrainës është për shkak jo vetëm i ngurrimit të shumicës së qeverive të BE-së, për të furnizuar Ukrainën me armë.

Përveç argumenteve të pafundme, mbi atë nëse dërgimi i armëve do ta inkurajojë Putinin për të përshkallëzuar apo zbutur konfliktin, kjo mosdashje gjithashtu rrjedh nga fakti se shumica e qeverive evropiane nuk besojnë se integriteti territorial i Ukrainës ka ndonjë rëndësi jetike për sigurinë e tyre.

Për shumicën e evropianëve, lufta në Ukrainë – ndryshe nga ajo ndaj Shtetit Islamik – nuk përbën kërcënim për mënyrën e jetesës dhe vlerat e tyre. Megjithatë, lufta ka vënë në pikëpyetje vlerat e Evropës dhe parimin e kufijve të padhunueshëm. Cili udhëheqës evropian do ta mohonte këtë?

/“Carnegie Europe”/



Shtypur në emër të lirisë

IAN BURUMA

Nëse lejon qeverinë të ndalojë mendimet që ti urren, atëherë ti dobëson të drejtën tënde për të kontestuar një ndalim të ngjashëm, për pikëpamje me të cilat mund të biesh dakord. Me fjalë të tjera, liri e shprehjes do të thotë gjithashtu liri e shprehjes së urrejtjes, sa kohë që kjo nuk rrezikon apo nxit dhunën

Aktet e terrorit mund të shkaktojnë dëme të tmerrshëm. Por ata nuk mund të shkatërrojnë një shoqëri të hapur. Vetëm ata që qeverisin demokracitë tona mund ta bëjnë këtë, duke na i tkurrur liritë në emër të lirisë.

Shinzo Abe, kryeministri nacionalist i krahut të djathtë i Japonisë, nuk ka nevojë për shumë nxitje që të shtrëngoje ligjet e fshehtësisë, t'i japë më shumë kompetenca policisë, apo ta bëjë më të kollajtë përdorimin e forcës ushtarake. Ekzekutimet e lemerishëm të dy nënshtetasve japonezë nga terroristët e Shtetit Islamik në Siri kanë ofruar pikërisht nxitjen që i duhet Abes për të ndërmarrë masa të tilla. Por Japonia nuk është parë asnjëherë si një bastion i lirisë së fjalës, as nuk ka pretenduar që të jetë. Franca po. Pikërisht, për lirinë e fjalës ndodhën edhe demonstratat e solidaritetit në vijim të sulmeve terroristë në Paris muajin e kaluar. Franca, nga të gjithë vendet, do të shmangte kurthin ku ngeci republika tjetër e

madhe e Perëndimit që pretendon të jetë feneri i lirisë në botë.

Frika nga dhuna terroriste që pas sulmeve të 11 shtatorit i ka bërë më shumë dëm lirisë në SHBA, se sa vrasja e mijëra qytetarëve të vet në ato atentate kamikazësh. Për shkak të asaj frike, amerikanët lejojnë që të spiunohen pa dallim nga qeveria e tyre, dhe lejojnë që të dyshuarit për terrorizëm të torturohen dhe të burgosen pa afat dhe pa gjyq.

Franca, ashtu si shumica e shteteve të tjerë në Bashkimin Europian, e ka tashmë një ligj i cili ndalon gjuhën e urrejtjes. Ligjërisht nuk mund të fyesh njerëzit në bazë të racës së tyre, besimit apo orientimit seksual. Dhe në Francë, ashtu sikurse dhe në disa vende të tjerë, mund të ndiqesh penalisht nëse mohon Holokaustin si dhe gjenocide të tjerë historikë.

Presidenti François Hollande, i cili nuk është një nacionalist i krahut të djathtë si Abe, tani dëshiron t'i forcojë këta ligje. Ai ka propozuar nisma të reja ligjore që do të bënin kompani të internetit si Google apo Facebook përgjegjëse për cdo lloj gjuhe të urrejtjes që do të hidhej në internet nga përdoruesit e tyre.

Ish krerë shtetesh të BE-së kanë mbështetur gjithashtu një propozim të udhëheqësve hebrej të Europës për të shpallur të paligjshëm dhe dënuar në cdo gjykatë të BE jo vetëm antisemitizmin dhe mohimin e gjenocidit, por edhe "ksenofobinë" në përgjithësi. Pak njerëz do të donin të mbronin shprehjet e ksenofobisë apo antisemitizmit. Po a është vërtetë gjë e mencur që të përdorësh ligjin për të ndaluar mendimet?

Së pari, ligje të tillë, nëse do të miratohen, pak gjasa ka që të reduktojnë rrezikun e akteve terroristë. Ndalimi i shprehjes së mendimit nuk do i bëjë të zhduken.

Ata do të vazhdojnë të shprehen, ndoshta më fshehtësisht, e si pasojë do të bëhen edhe më helmues. Dhe baza sociale dhe politike e terrorizmit, në Lindjen e Mesme dhe gjetkë, nuk do të zhduket nga faqja e dheut thjeshtë sepse ndalove publikisht gjuhën ksenofobe.

Por ekziston një rrezik më i madh i përdorimit të ligjit për të kontrolluar atë që mendojnë njerëzit. Ky mund të shkaktojë debat publik. Ky rrezik vë theksin në këndvështrimin (ende në fuqi në SHBA), se mendimet, sado të këqinj, duhet të shprehen lirisht, me qëllim që ata të kundërshtohen me kundëargumenta.

Sigurisht, do të ishte naive të besonim se ekstremistët fetarë apo politikë janë të interesuar në shkëmbimin e ideve. Por nxitja e dhunës është e ndaluar edhe në SHBA. Amendamenti i parë i Kushtetutës nuk të mbron nga liria e shprehjes, atëherë kur provohet se ajo mund të krijojë rrezik për dhunë.

Pikëpamjet ksenofobe, apo mohimi i gjenocidit, janë të neveritshme, por ato nuk rezultojnë domosdoshmërisht në një rrezik të tillë. Në shumicën e shoqërive, përfshirë SHBA, shprehja publike e mendimeve të tillë është e kufizuar në një konsensus të përgjithshëm mbi atë që është e respektueshme shoqërisht. Ky konsensus ndryshon me kohën. U takon botuesve, shkrimtarëve, politikanëve dhe të tjerëve që flasin në publik që t'i japin formë.

Karikaturistët, artistët, blogger-at, aktivistët dhe komedianët ndodnjëherë pëlqejnë të sfidojnë konsensusin e respektueshmërisë. Disa prej këtyre sfidave mund të shkaktojnë zemërim (në fund të fundit ky është qëllimi). Por sa kohë që nuk nxisin dhunën, më shumë do të bëhej dëm se sa mirë, nëse do të ndaloheshin me ligj. Lejimi i qeverisë të vendosë se cilët mendime janë të lejueshëm është i rrezikshëm, jo thjeshtë sepse mbyl debatin, por edhe sepse qeveritë mund të jenë arbitrare apo në shërbim të interesave të tyre.

Në klimën aktuale të frikës, do të ishte e dobishme të kujtonim një rast të famshëm të gjuhës së urrejtjes në SHBA. Në vitin 1977, Partia Naziste Amerikane planifikoi që të zhvillonte një demonstratë në Skokie, një rrethinë e Chicagos me një popullsi të madhe hebrejsh. Një gjykatë lokale, e nxitur prej opinionit publik të tronditur dhe frikësuar, vendosi që shfaqja e kryqeve të thyer, shpërndarja e fletëpalosjeve dhe mbajtja e uniformave naziste duhej ndaluar. Një demonstrim

i tillë, u argumentua nga gjykata, do të ishte fyerje për një komunitet ku kishte edhe të mbijetuar të Holokaustit.

Por ky ndalim u kontestua nga Unioni Amerikan i Lirive Civile si shkelje e Amendamentit të Parë. Argumenti i avoketërve të Unionit, shumica prej të cilëve ishin hebrenj liberalë, nuk bazohej në ndonjë simpati për pikëpamjet apo simbolet naziste. Argumenti i tyre ishte se, nëse lejon qeverinë të ndalojë mendimet që ti urren, atëherë ti dobëson të drejtën tënde për të kontestuar një ndalim të ngjashëm, për pikëpamje me të cilat mund të biesh dakord.

Me fjalë të tjera, liri e shprehjes do të thotë gjithashtu liri e shprehjes së urrejtjes, sa kohë që kjo nuk rrezikon apo nxit dhunën. Shumica e qeverive europiane që tani kanë një pikëpamje më strikte ndaj fyerjeve publike se sa Gjykata Kushtetuese e SHBA. Do të ishte gabim i madh të shtoheshin edhe më shumë kufizime. Boll dëm po shkaktojnë sulmet terroristë. Nuk ka nevojë që qeveritë t'i përkeqësojnë gjërat duke shtypur liritë e qytetarëve të tyre.

Marrë me autorizim nga Project Syndicate, 2015. Ripublikimi mund të bëhet vetëm me lejen e Project Syndicate – Muzzled in the Name of Freedom



Larg duart nga Pranvera Arabe!

UMBERTO DE GIOVANNANGELI

“Pranvera” nuk do të arkivohet. Një koncept që i takon edhe historianit, i cili ka reflektuar më shumë për botën arabe dhe dinamikën e saj komplekse të brendshme: Zhill Kepel. “Revolucionet arabe nuk kanë përfunduar ende – shkruan Kepel. Dhe protagonistët e tyre nuk e kanë shqiptuar ende fjalën “fund”. Shoqëritë civile, nuk kanë hequr dorë nga të ndjerit të papajtueshmëm me islamikët. Sot kudo po kërcëhet “Harlem Shake” për të vënë në lojë mjekëroshët. Në Egjipt dhe Tunizi, Vëllazëria Myslimane gabimisht besoi se rendi moral do të përmbushte kërkesat sociale të revolucionarëve. Pastaj, kemi paradoksin e salafitëve

Ata brohoritën fundin. Dhanë dënimin. Tani thonë se ajo ishte e gjitha një iluzion. Pikërisht ato sheshe të mbushura me të rinj, ato kryengritje që ndryshuan rrjedhën e historisë. Tani thonë se “Pranvera” e shpresës, u zbeh duke përfunduar në një “Dimër” islamik tragjik. Se në të tashmen dhe të ardhmen e Lindjes së Mesme, ka hapësirë vetëm për “Kalifët” e etur për gjak, apo për gjeneralë despo-

tikë të maskuar si presidentë. Një ëndërr u shndërrua në një makth. Të shumtë ishin ata që vunë theksin tek "de profundis" (fundi) i një sezoni të paharrueshëm: ai i trazirave të vitit 2011 që rrëzuan regjimet, të cilët deri atëherë cilësoheshin të paprekshëm, nga Tunizia e Ben Alisë, tek Egjiptit i Hosni Mubarakut.

Po t'i shohim, dhe ç'është më e rëndësishmja po t'i dëgjojmë këto zëra, vihet theksi tek rëndësia epokale e ngjarjeve, pavarësisht nga rezultati i njëjtë që sollën revolucionet më pas. Pasi për herë të parë, në mënyrë aq të fuqishme, bota e globalizuar nuk është e tillë, vetëm për logjikën (dhe interesat) e tregut. "89-a arabe" është gjithashtu rezultat i një bote më të zhytur ose të heshtur, që zotëron skenën, për të pretenduar një tjetër globalizëm: atë të të drejtave.

Një pretendim, që ripërcakton vetë ndjenjën e përkatësisë, jo më e bazuar mbi elementin fetar ose tek individualizimi i "armikut" që duhet mundur, por e kalibruar mbi vlerat dhe parimet që perceptohen dhe jetojnë si universale. Mbi këtë bazë, të rinjtë e Pranverave Arabe, brezi i internetit, kërkojnë dialog me Perëndimin, me botën e lirë.

Por nuk e marrin këtë dialog. Realpolitika, që mëton të justifikojë çdo gjë, madje edhe të keqen, parimet e shpërfaqura e menjëherë të sakrifikuara në altarin e padenjës të llogarive të fitimit ekonomik të fuqive individuale, diplomacisë së bishtnimit, përherë mbetur pezull mes heshtjeve bashkëfajtoresh dhe intervencionizmave të mpira, çdo gjë ndihmon vetëm pjesërisht për të kuptuar domethënien e ngjarjeve dhe përgjegjësi ndërkombëtare.

Ajo që nuk duhet të kuptohet, është se këto revolucione nuk ishin "anti" por "për". Për demokracinë, lirinë e shprehjes, drejtësinë sociale, çrrënjosjen e korrupsionit, për një Islam që në mënyrë të qartë ndan shtetin nga xhamia. Një perspektivë, që i pranon të drejtat e njeriut, liritë politike dhe të shprehjes si vlera universale, por nuk i identifikon ato dhe parimet me një model, me jetesën "perëndimore".

Ajo mes "vlerave" dhe "modeleve", nuk është një dallim formal, semantik. Është një dallim thelbësor, për një qasje kulturore dhe politike, nga ana e Perëndimit, udhëheqjes së tij të opinionit publik, "Pranverave arabe" që nuk u shenjuan nga mendimi retro-kolonial: vula e fitores së Perëndimit, ndaj islamit arab.

Eksperti i demokracisë nuk kryhet më me armë (si në Irak), por në mënyrë indirekte, të brendshme, e për këtë arsye fituese. Vizioni hantingtonian – "përplasje e qytetërimeve" – i ka shërbyer "eksportuesve të demokracisë" për të mbuluar logjika dhe interesa më pak "vizionare": kontrollin e burimeve të naftës, teatrot e reja të luftës, në të cilat lulëzojnë punët e industrisë ushtarake, mbështetjen ndaj të ashtuquajturve të "moderuar", të konsideruar si elementë stabiliteti për ekulibrat rajonalë dhe veçanërisht për Perëndimin.

Revolucionet post-islamike dhe lojtarët e tyre kryesorë nuk kishin të bënin fare me paradigmen politike fundamentaliste. Ata donin të "globalizonin" të drejtat, jo xhihadin. Për këtë arsye, ata duhet të dëgjoheshin, mbështeteshin dhe mbroheshin. Mjerisht, nuk ndodhi kështu. Në këtë perspektivë, historia e sotme është edhe historia e një "tradhtie të madhe", kundër të rinjve egjiptianë të sheshit Tahrir, djelmohave tunizianë të "revolucionit lejla" dhe bashkëmohatarëve të tyre në Siri, që u përpoqën t'i japin jetë "Pranverës siriane", e shtypur me dhunë nga regjimi.

Sikurse vëren edhe Luço Karaçiollo, drejtori i revistes gjeopolitike "Limes", sot është në modë arkivimi i "Pranverës Arabe" si "Dimri arab" apo "islamik. Gabim tejet i rëndë. Trazirat, që shpërthyen 4 vjet më parë në Tunizi dhe Egjipt, shpejt u përhapën nga Libia në Siri, Bahrein, Jemen dhe gjetkë. Kundër tyre u mobilizua një front kundërrevolucionar, i përqëndruar në Arabinë Saudite dhe emiratet satelite të saj, që gjithësesi nuk i raskapiti dot kryengritësit. Nëse është e vërtetë – shkruan Karaçiollo – se ajo turbinë u ngrit prej ndryshimeve të thella gjeopolitike, ekonomike, kulturore dhe sociale, duhet ende të presim, përpara se të japim

gjykime të nxituara.

Të presim, por jo në mënyrë pasive. Për shkak se ai univers në lëvizje nuk është zhdukur. Përkundrazi ekziston, edhe pse dukshmëria e saj është më pak përçarëse. Atë e popullojnë kryesisht të rinjtë dhe gratë. Lëvizja e këtyre të fundit ishte dhe mbetet një luftë e dyfishtë çlirimtare. Në bluza dhe xhinse, apo me veshje dhe vello të zezë e të gjatë, dhjetëra mijëra, bënë që të dëgjohet zëri i tyre, në të paharrueshmin viti 2011, në rrugë, nga Tunizi në Kajro nga Manama në Sana. Shumica të reja, në rradhët e para, krenare, të vendosura: sikurse ishte Sallli Zahran, 23-vjeç, e vrarë nga policia egjiptiane, gjatë protestave të mëdha të së parës “E premtja e kolerës” 28 janar 2011. Gra kurajoze, të angazhuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ato civile, edhe para shpërthimit të ’89-ës arabe. Ky është rasti i Radhia Nasrauit, avokate, feministe, presidente e shoqatës për luftën kundër torturës në Tunizi. Një e kaluar në fshehtësi, burgje dhe greva urie, ishte e para në 17 dhjetor 2010, që udhëhoqi kryengritjen popullore në Sidi Bouzid, ku filloi çdo gjë.

Ndërkohë fuqia e butë vazhdon të shtypë edhe mbretërinë e padepërtueshme saudite, me lëvizjen e “grave shofere”. Thyerja e së tashmes është shfaqja e rasteve të lirisë, që flasin për një islam pluralist, në të cilin është e mundur të provohet të kombinohet moderniteti dhe tradita. Katër vitet që kanë kaluar prej atëherë, dëshmojnë sesi formacionet xhihadiste janë çdo gjë, përveçse jo të marginalizuara. Në disa raste, ISIS-i “ka bërë shtet”.

Fakt është se axhenda e revolucioneve post-islamike, lojtarët e saj kryesorë, nuk kanë të bëjnë me paradigmen politike fundamentaliste. Kodet e lirisë nuk u humbën. Ato janë ruajtur në vetvete, sigurisht jo në shkurtesat e mjeruara militariste, në të cilat në mënyrë ciklike detyrohet Perëndimi, antitrupat e vërtetë që përparojnë kundër “diktaturës së sheriatit”.

Mbi këtë reflekton edhe Olivier Roj, një nga dijetarët francezë më me ndikim për çështjet rreth Islamit: “Për njerëzit e përfshirë në protesta, lëvizjet e mëdha revolucionare të viteve ’70-’80 i përkasin një historie tjetër, atë të prindërve të tyre. Brezi i ri nuk është i interesuar mbi ideologjinë: tek ta më tepër “ndezin” parrullat pragmatike dhe konkrete “erhal” (largohu menjëherë). Ata shmangin referencat ndaj Islamit, sikurse ndodhte dikur në Algjeri në fund të viteve ’80. Kundërshtojnë diktaturën dhe kërkojnë me zë të lartë demokracinë “. Dhe ai zë nuk ka vdekur, ndonëse të shumtë janë ata prej xhihadistëve, ushtarakëve egjiptiane, ISIS-it apo Al-Kaedës, që janë përpjekur t’ia mbyllin gojën me forcë. Prandaj, ndoshta është më e përshtatshme ndaj realitetit dhe të ardhmes historike, për të mos folur më për “Pranverat Arabe”, por të shikohet Egjipti, Tunizia, Libia, Maroku, Jordania dhe Jemeni si “vende në tranzicion”.

Dhe “tranzicion” është një kusht që qëndron në mes, që mund të dështojë, ashtu sikundër mund t’ia dalë. Kjo thërret në detyrë Evropën, dhe në plan të parë vendet e saj euro-mesdhetare. Pra Italinë. Me logjikën e “të keqes më të vogël”, ne mbështetëm kolonelët, faraonët, diktatorët gjakatarë dhe regjimet teokratike. Sepse ata pretendonin se ishin “e keqja më e vogël”, në krahasim me fundamentalistët integralistë. Kjo logjikë fatale ka prodhuar El-Bagdadin dhe gjeneralin egjiptian El-Sisi.

Por në Lindjen e Mesme ka ndërkaq një forcë të tretë, sigurisht në telashe, por jo të mundur. Ajo është shoqëria civile. Janë organizatat e saj të bazës, është sindikalizmi (Tunizi). Janë vajzat dhe djemtë e sheshit Tahrir, grupet e të drejtave të njeriut, blogerët e guximshëm, shumë prej atyre që i thonë jo vendosjes së Kalifit të kokëprerjeve në Siri, ashtu edhe presidentit-kasap (Bashar al-Assad). Këta të rinj, janë investimi i së ardhmes.

Për sa kohë që do të jenë ata, “Pranvera” nuk do të arkivohet. Një koncept që i takon edhe historianit, i cili ka reflektuar më shumë për botën arabe dhe dinamikën e saj komplekse të brendshme: Zhill Kepel. “Revolucionet arabe nuk kanë

përfunduar ende – shkruan Kepel. Dhe protagonistët e tyre nuk e kanë shqiptuar ende fjalën “fund”. Shoqëritë civile, nuk kanë hequr dorë nga të ndjerit të papajtueshmëm me islamikët. Sot kudo po kërcëhet “Harlem Shake” për të vënë në lojë mjekëroshët. Në Egjipt dhe Tunizi, Vëllazëria Myslimane gabimisht besoi se rendi moral do të përmbushte kërkesat sociale të revolucionarëve. Pastaj, kemi paradoksin e salafitëve, që i drejtohen të zhgënjyerve nga revolta, duke premtuar një utopi radikale dhe një rend të ri social. Pa treguar megjithatë, se përse ata vetë janë aq të përkushtuar ndaj rregjimeve të financuara nga monarkitë e Gjirit, të cilat mbrojnë mosveprimin”. Një palëvizshmëri që “i paharrueshmi viti 2011” e ka degdisur tutje.

Nga ana tjetër, duke iu referuar sërish Kepelit, nëse revolucionit francez iu desh një shekull për t’u trupëzuar tek institucionet, ne nuk mund të mos pranojmë, se jemi vetëm në agimin e një pranvere, dhe jo drejtpërdrejt “në vjeshtë” apo “dimër”.

Roberto Toskano, ish-ambasador i Italisë në Iran dhe Indi, në një ese të shkruar së bashku me Marta Dassù për “Instituti Aspen” ndër të tjera shprehej: “Zakonisht, ne në Perëndim priremi të harrojmë se na janë dashur shekuj, për të lëvizur nga tiranitë dhe monarkitë absolute në demokraci. Në mënyrë të paarsyeshme besonim se pas zgjimit të tyre të mrekullueshëm, arabëve do t’u mjaftonin vetëm pak muaj.

Nuk mund të ishte kështu, por ne në mënyrë të arsyeshme mund të shpresojmë, se sigurisht nuk do të bëhet fjalë për shekuj, por për dekada të tëra, dhe në rastin më të mirë për disa vite. Kjo do të varet krejtësisht prej tyre, por edhe nga ne, nëse do të dimë të kuptojmë dhe t’i shoqërojmë me largpamësi e me një ndjenjë përgjegjësie, me mbikëqyrje por edhe një sens kritik, udhëtimin e tyre të vështirë”. Si të mos pajtohesh me një konstatim të tillë? /HuffPost.it/



I dashur perëndimor...!

NGA SHADY HAMADI*

Letër një perëndimori: Mbështesni shoqërinë arabe kundër fanatizmit dhe diktaturave. “ISIS-i nuk është totalitarizmi i parë me të cilin unë janë përballur. Por ai është fytyra më e mediatizuar e një makthi të vjetër, me të cilin unë kam bashkëjetuar”. “Sot jeta e një arabi është shumë e brishtë dhe vlen po aq sa një bidon me benzinë. Megjithatë, ti mos u habit nëse shoqëria ime është shëmtuar”

I dashur perëndimor!

Në vitin 2010, revolucionet shpërthyen në shtëpinë time, botën arabe. Diktaturat dinastike u rrëzuan, duke i lënë hapësirë – për herë të parë në historinë bashkëkohore arabe – mundësisë për të zgjedhur. Për çfarë zgjedhje po flas? E kam fjalën tek mundësia për të vendosur mbi të ardhmen e tyre.

Brezi im dhe ai i tim eti u rritën nën një president të vetëm, që kur vdiq i la postin e tij të birit. Në 50 vitet e fundit, bota ime është përshkruar nga nacionalizmi arab, i zbehur me vdekjen e Naserit dhe nga makthet e totalitarizmave arabe. Kështu, ISIS-i nuk është totalitarizmi i parë me të cilin unë janë përballur. Por ai është fytyra më e mediatizuar e një makthi të vjetër, me të cilin unë kam bashkëjetuar.

Mizoritë e ISIS-it, që ti i shoh nëpërmjet televizionit, unë tashmë i kam përjetuar.

Kam parë masakrat në burgjet arabe, sulmet me armët kimike, arrestimet arbitrare. Kam qenë dëshmitar i gjenocideve të kryera nga regjimet tona dhe kjo është arsyeja se përse s'befasohem më prej barbarive.

Sot jeta e një arabi është shumë e brishtë dhe vlen po aq sa një bidon me benzinë. Megjithatë, ti mos u habit nëse shoqëria ime është shëmtuar. Duhet të dish se për 50 vjet, fëmijët në shkollë çdo mëngjes janë betuar për të mbrojtur deri në vdekje "presidentin e tyre të dashur".

Ky president, njeriu i të mbinatyrshmes, gjysmëperëndi, shtypte të gjithë disidentët, dhe bënte biznes duke ua shitur pasuritë tona natyrore fuqive botërore, pikërisht atyre vendeve që edhe pse himnizojnë të drejtat e njeriut, gjithësesi në vend të tyre kanë qenë në gjendje t'i shkëmbejnë ato për një fuçi naftë.

Shoqëritë tona janë goditur nga individualizmit radikal (kjo për shkak të mungesës së besimit, që rrjedh nga paranoja e zhvilluar, për shkak të pranisë së gjerë të shërbimeve të sigurisë), dhe kjo ka rezultuar në shpërbërjen e ndjenjës së bashkësisë kombëtare.

Është kjo arsyeja se përse çdo lloj tranzicioni politik tek ne është shumë i vështirë. Dua t'i drejtohem atij, që me ty në Perëndim, sot mendon se "arabët ishin më mirë me Gedafin, Ben Alinë dhe Mubarakun, sepse ata ishin e keqja më e vogël dhe garantonin statuskuonë".

Kush formulon të tilla gjykime nuk ka kaluar sigurisht një ditë të vetme në burgjet e atyre regjimeve, nuk bart në trup asnjë shenjë torture dhe as ka jetuar ndonjëherë në mërgim të detyruar. Shfaqja e ISIS-it i ka bërë një favor të madh atyre që kërkojnë rivendosjen e rendit të vjetër në botën arabe.

Në fakt, që kur kjo organizatë terroriste është shndërruar në një problem edhe për ju – për shkak të prerjes së kokave të gazetarëve perëndimorë dhe vullnetarëve të organizatave humanitare – të cilët bënin tifo kundër "Pranverës Arabe", ajo dhe fitoi luftën e perceptimeve.

Sot të dëgjosh një arab që kërkon lirinë, evokon të drejtën e vetëvendosjes, tingëllon si qesharake. "Këta arabët, nuk janë të aftë si ne, të qeverisin veten e tyre" – thonë shumë syresh, dhe kjo ka bërë, që disa të besojnë, se është më mirë të rivendosjen në pushtet njerëzit e vjetër të regjimit, si psh El-Sisi në Egjipt.

Veprat e ISIS-it, i dashur mik perëndimor, po delegjitojnë sakrificën e qindra-mijëra arabëve, të cilët protestuan nga Sheshi Tahrir në Kajro deri në Damask të Sirisë, duke brohoritur për liri e duke marrë si përgjigje plumbat e represionit. Fundamentalizmi është një problem veçanërisht për ne. Është fakt që ISIS-i po therr më shumë myslimanë sesa të krishterë, por kujdesi yt për të vajtuar vetëm fatin tragjik të këtyre të fundit, vetëm sa do të rrisë radikalizmin. Pasi myslimanët do të ndihen përherë viktimat e serisë B, dhe kjo s'mund të bëjë gjë tjetër veçse të shtojë radhët e radikalëve.

Për më tepër, veprat e këtyre terroristëve po ofrojnë argumentet e nevojshme për "sipërmarrësit e frikës" për të thënë se "të gjithë myslimanët janë terroristë". Së fundmi, ISIS-i po e largon vëmendjen tuaj nga ajo që po ndodh në botën arabe: shihni bombardimet ajrore mbi qytetet siriane nga Asadi, fushatat e arrestimeve dhe ekzekutimeve kundër aktivistëve të paqes në Egjipt, arrestimet në Arabinë Saudite, Bahrein dhe katasfrofa e ditëve të fundit në Jemen.

Më lejo ta përfundoj, duke të kërkuar reciprocitet. Reciprocitet për mirënjohjen, respektin dhe dialogun. Të kërkoj të marrësh në konsideratë çdo të vdekur nga seria A. Kemi nevojë të kuptojmë njëri-tjetrin. Lipset të besojmë së bashku se liria nuk i përket ekskluzivisht një qytetërimi të caktuar, por çdo lloj qenieje njerëzore. Së fundmi, të ftoj të zgjedhësh të mbështesësh shoqërinë arabe: atë që e refuzon fanatizmin dhe diktaturën. Vetëm kështu, do të ketë shpresë se muret e reja do të rrëzohen së bashku me fanatizmin dhe diktaturat. /Il Fatto Quotidiano/

Shkrimtar, i lindur në Milano në 1988, me nënë italiane dhe baba sirian



Ku duhet t'i kërkojmë rrënjët e terrorizmit?

PETER BERGEN

Dhe historia në fakt na tregon se terrorizmi është përgjithësisht një ndërmarrje borgjeze. Kjo ishte po aq e vërtetë për anarkistët rusë në fundin e shekullit XIX-të, marksistët gjermanë të grupit terrorist në Gjermaninë Perëndimore “Baader-Meinhof” në vitet '70 dhe të grupit japonez terrorist “Aum Shinrikyo” në vitet '90

Tashmë një cunam i parashikueshëm gjërash ta pakuptimta ra mbi kryet tona, që lidhet me ato që quhen “shkaqet rrënjësore” të terrorizmit. Kemi dëgjuar shpesh nga zyrtarët e administratës Obama e madje edhe vetë presidenti, se terrorizmi ka të bëjë me mungesën e mundësive dhe varfërinë. Obama tha të mërkurën se “ne duhet të adresojmë ankesat e njerëzve, të cilat i shfrytëzojnë terroristët, duke përfshirë edhe kërkesat ekonomike”.

“Kur miliona njerëz – veçanërisht të rinjtë – janë të varfër dhe nuk kanë asnjë shpresë për të ardhmen, kur korrupsioni shkakton poshtërime të përditshme, kur nuk ka institucione ku njerëzit mund të shprehin shqetësimet e tyre, zemërimi rritet. Dhe bashkë me të edhe rreziku për paqëndrueshmëri dhe ekstremizëm.

Aty, ku të rinjtë nuk kanë arsimim, janë më të prekshëm nga teoritë e konspiracionit dhe idetë radikale ..." – deklaroi ndër të tjera Obama.

Ndërkaq, presidenti e pranoi se terroristët mund të jenë edhe persona të pasur, sikurse ishte Osama Bin Ladeni, biri i një manjati arab të ndërtimit, që ndoqi gjimnazin dhe universitetin më të mirë në Arabinë Saudite. Është e vështirë të imagjinohet dikush me më tepër mundësi sesa ish-kreu i Al-Kaedas.

Mendoni për një moment familjen Tramp nën një stil saudit, hiqni shpenzimet e tepruara, dhe do të bini në një admirim të thellë për talebanët. Por në fakt Osama bin Ladeni përbën më shumë një rregull sesa një përjashtim. Merrni për shembull Muhamed Atan, djalin e një avokati egjiptian, i cili kishte punuar për një doktoraturë mbi ruajtjen e urbanizmit në një universitet gjerman, dhe që dihet tanimë se udhëhoqi sulmet 11 Shtatorit 2001 në SHBA.

Apo merrni udhëheqësin e tanishëm të Al Kaedës, Ajman Al- Zauahirin, një kirurg që rrjedh nga një prej familjeve kryesore egjiptiane, e cila ka nxjerrë nga rradhët e saj politikanë të rëndësishëm, ambasadorë, dhe klerikë të shquar. Më pranë shtëpisë sonë, mund të përmendim rastin e majorit të bazës ushtarake amerikane të "Fort Hood"-it, Nidal Hasan, që ishte jo vetëm një oficer i ushtrisë amerikane dhe psikiatër, por gjithashtu vinte nga një familje e qetë e klasës së mesme në Virxhinia.

Le të shtojmë këtu rastin edhe e Faizal Shahzadit, i cili u përpoq të hidhte në erë një autobombë në sheshin "Times Square Garden" në Nju Jork në 1 maj të vitit 2010. Ai kishte marrë një doktoraturë në Shtetet e Bashkuara dhe kishte punuar si analist financiar për kompaninë e njohur kozmetike "Elizabeth Arden". Babai i tij ishte një nga oficerët më të lartë në ushtrinë pakistaneze.

Ata s'janë dobësuar, përkundrazi janë fuqizuar

Instituti "Amerika e Re" ka studiuar prejardhjen e mbi 250 militantëve islamikë me bazë në SHBA, që prej sulmeve të 11 Shtatorit, të cilët janë paditur apo dënuar për krime të ndryshme terroriste. Ata janë pjesë e klasës së mesme, njerëz me arsye, të mirë-arsimuar, dhe familjarë me fëmijë. Me pak fjalë, ata janë amerikanë të zakonshëm.

Në mënyrë të ngjashme, në librin e tij të rëndësishëm në vitin 2004 "Të kuptosh rrjetet terroriste", psikiatri Mark Seixhman, një ish-oficer i CIA-s, shqyrtoi prejardhjen e 172 militantëve të cilët kishin qenë pjesë e Al-Kaedës apo ndonjë grupi të ngjashëm terrorist. Më pak se gjysma e tyre ishin profesionistë; dy të tretat i përkisnin klasës së mesme dhe kishin shkuar në kolegji; ndërsa disa prej tyre madje kishin edhe doktoratura.

Në një studim të vitit 2006, unë dhe Svati Pandej shqyrtuam preardhjen arsimore të 79 terroristëve, përgjegjës për 5 nga sulmet më të rënda terroriste anti-perëndimore në epokën moderne: bombardimin në Qendën Tregtare Botërore në Nju Jork në vitin 1993, shpërthimet në dy ambasadat amerikane në Afrikë në vitin 1998, sulmet e 11 Shtatorit, bombat në një klub nate në Bali të Indonezisë në vitin 2002, si dhe shpërthimet në Londër më 7 korrik 2005.

Ne konstatuam se më shumë se gjysma e terroristëve kishin përfunduar gjimnazin, çka i bën ata të mirë-arsimuar, po të kesh parasysh amerikanin mesatar. Dy nga rastet, që ne morëm në shqyrtim kishin grada shkencore, ndërsa dy të tjerë kishin filluar të punonin për të mbrojtur doktoraturat. Asnjëri prej tyre nuk kishte studiuar ndonjëherë në ndonjë medrese. Sigurisht, që në një shkallë të madhe grupe kryengritëse të tilla si ISIS-i apo dhe talebanët rekrutojnë luftëtarët të rinj, në këmbim të pagimit të një çeku të majmë financiar. Por njerëzit që bënin pjesë në këto organizata kishin arsye ideologjike.

Një pikëpamje optimiste

Analiza se varfëria, mungesa e arsimit apo e mundësive kanë shumë të bëjnë me terrorizmin, mëton për një pikëpamje rrënjësisht optimiste rreth natyrës njerëzore. Kjo diagnozë të çon tek parashikimi, se ajo që të gjithë duhet të bëjmë,

për të zgjidhur problemin e terrorizmit, është të krijojmë shoqëri që janë më pak të varfra, më të mirë-arsimuara dhe që kanë më tepër mundësi. Por fakti është se ata që kanë një punë jo të mirë dhe që u ofron mundësi të pakta dhe edukim të pamjaftueshëm, në përgjithësi janë shumë të zënë, për t'u marrë me projekte revolucionare dhe ribërë shoqërinë.

Dhe historia në fakt na tregon se terrorizmi është përgjithësisht një ndërmarrje borgjeze. Kjo ishte po aq e vërtetë për anarkistët rusë në fundin e shekullit XIX-të, marksistët gjermanë të grupit terrorist në Gjermaninë Perëndimore "Baader-Meinhof" në vitet '70 dhe të grupit japonez terrorist "Aum Shinrikyo" në vitet '90.

Studimet pas sulmeve të 11 Shtatorit 2001, që dëshmojnë se terrorizmi islamik është më së shumti një ndërmarrje e klasës së mesme, i bënë jehonë edhe një studim i rëndësishëm mbi militantët egjiptianë, i kryer nga akademiku francez Zhill Kepel, gjatë mesit të viteve '80. Kepel hulumtoi mbi jetët e 300 militantëve islamikë, të cilët u gjykuan si përgjegjës për vrasjen në vitin 1981 të presidentit egjiptian Anvar Sadat.

Afërsisht 1 në 5 prej tyre ishin profesionistë në fusha të tilla si inxhinieritë, një e katërta e tyre kishin punuar në administratën qeveritare, dhe vetëm më pak se gjysma ishin artizanë ose tregtarë. Një në 10 prej tyre kishin qenë pjesëtarë të ushtrisë apo policisë, ndërsa po 10 përqind e tyre ishin fermerë apo të papunë. Nga ata që ishin studentë, rreth një e treta kishin studiuar në degë të cilësuar elitare si mjekësia dhe inxhinieria. Në mënyrë të ngjashme, Biblioteka e Kongresit Amerikan ka publikuar një studim dy vjet para sulmeve të 11 Shtatorit, mbi çështjen: "Kush bëhet terrorist dhe përse". Përfundimi, i bazuar në një mbikëqyrje të gjithë literaturës së botuar mbi këtë çështje, ishte se kishte vetëm disa "përrjashtime të mëdha për klasën e mesme dhe të mesme të sipërme, mbi origjinën e grupeve terroriste".

Natyrisht që ka një numër përjashtimesh nga prototipi i klasës së mesme, që përfshihet në terrorizëm. Terroristët që sulmuan revistën satirike franceze "Charlie Hebdo" në Paris muajin e kaluar apo edhe kafenenë në Kopenhagen, ku ndodhej në një aktivitet, karikaturisti suedez Lars Vilks fundjavën e kaluar, ishin nga skajet e shoqërisë. Por për çdo shembull varfërie apo mungese të mundësive, si një arsytim i supozuar për terrorizëm, është shumë e lehtë për të sjellë kundërsimbuj të rëndësishëm.

"Bombarduesi i brendshëm" Umeri Abdylmutalab, që u përpoq të vendoste një bombë në një avion pasagjerësh në SHBA, i cili po fluturonte mbi Detroit ditën e Krishtlindjeve në vitin 2009, është djali i një prej njerëzve më të pasur në Afrikë. Ai kishte përfunduar studimet në "University College" në Londër, i cili në mënyrë të vazhdueshme renditet në mesin e universiteteve më të mirë në botë. Anvar Al-Aulaki, ish-udhëheqësi i Al Kaedës në Gadishullin Arabik, që kishte planifikuar të hidhte në erë një aeroplan mbi një qytet amerikan, ishte duke studiuar për marrjen e gradës profesor-doktor në Universitetin "Xhorxh Uashington", para se t'i bashkohej Al-Kaedës. Babai i Aulakit ishte një ministër në kabinetin qeveritar në Jemen.

Atëherë çfarë e nxit terrorizmin?

Pra, në qoftë se në mënyrë të qartë rezulton se nuk është privimi nxitësi kryesor ndaj terrorizmit islamik, kush mbetet të jetë? Për të marrë një përgjigje të saktë, ne duhet t'i rikthehemi ideologjive dhe në mënyrë specifike, ideologjive fetare. Dhe pikërisht këtu është lëmi ku administrata Obama duhet të përqëndrohet më tepër. Ajo është e kujdesshme kur shpjegon se lufta kundër ISIS-it nuk është një luftë me Islamin, dhe se ideologjia e Shtetit Islamik është një shtrembërim që i bëhet kësaj feje. Mjaftueshëm e qartë.

Por administrata nuk ndihet rehat kur bëhet lidhja midis terrorizmit islamik dhe formave të tjera ultra-fundamentaliste të Islamit, të cilat janë intolerante ndaj feve

të tjera, por dhe myslimanëve të tjerë që nuk ndajnë pikëpamjet e tyre. ISIS-i mund të jetë vërtetë një shtrembërim i Islamit, por islamik është, sikurse janë të krishtera besimet mbi shenjtërinë e fëmijës së palindur, çka shpjegon faktin se përse disa fundamentalistë kristianë sulmojnë klinikat ku kryhen aborte dhe mjekët që punojnë atje. Por, natyrisht, fundamentalistët e krishterë nuk po vrasin mijëra civilë në vit.

Më shumë se 80 përqind e sulmeve terroriste në botë ndodhin në 5 vende me shumicë myslimane – Afganistan, Irak, Nigeri, Pakistan dhe Siri – dhe kryhen kryesisht nga grupe me besim islam. Këtë javë OKB publikoi një raport që tregon se viktimat civile në Afganistan ishin në nivelin më të lartë, qëkur organizata kishte bërë llogarritjen e fundit, 6 vjet më parë. Dhe talebanët ishin përgjegjës për tre të katërtat e këtyre vdekjeve.

Sigurisht, talebanët dhe grupet e tjera islamike terroriste nuk janë organizata laike. T'i trajtosh ato si të ishin burim i një mendimi të kombinuar pozitiv vetë kompjuteri do të çmendej e nuk do të pranonte një pohim të tillë, në një epokë gjithnjë e më të laicizuar, që disa do të vrasin në emër të zotit të tyre, si një fenomen i përbashkët i të gjithë historisë njerëzore.

Në të vërtetë, ndërsa ISIS-i, grupe të ngjashme si dhe ithtarët e tyre nuk janë përfaqësues të shumicës dërrmuese të myslimanëve në botë, ideologjia e tyre i ka rrënjët në interpretimin salafist dhe ultra-fundamentalist të Islamit. Në fakt, ata mund të na tregojnë për ajete në Kuran, që mund të interpretohen për të mbështetur botëkuptimin e tyre.

Një varg i njohur në Kuran i urdhëron myslimanët që të “luftojnë dhe vrasin të pafetë kudo që ata gjenden, t'i marrin me dhunë dhe ngujojnë, dhe rrinë në pritë për ta në çdo manovër të luftës”. Kur Bin Ladeni bëri një shpallje formale të luftës kundër “hebrenjve dhe kryqtarëve” në vitin 1998, ai përmendi pikërisht këtë ajet Kuranor, në fillim të deklaratës së tij.

Flamuj e zinj që e dallojnë ISIS-in janë një referencë e një thënieje të supozuar të Profetit Muhamed që “nëse ju shihni pankartat e zeza, të cilat vijnë nga drejtimi i Khorasanit, pastaj duhet të shkoni drejt tyre edhe duke u zvarritur nëse është nevoja, sepse në mesin e tyre do të jetë Kalifi i Allahut Mahdiu”. Me fjalë të tjera, ardhja e Khorasanit, një zonë e cila aktualisht përfshin një territor të barabartë me Afganistanin do të sjellë një ushtri që përfshin Mahdiun, shpëtimtarin Islamik të botës.

Organizim të ngjashëm me ISIS-in kishte Al-Kaeda, e cila sigurisht ishte me seli në Afganistan në kohën e sulmeve të 11 Shtatorit. Vitin e kaluar, lideri i ISIS Ebu Bekr El-Bagdadi e quajti veten Kalif, që do të thotë se në mendjen e tij dhe në sytë e pasuesve të tij ai nuk është vetëm lideri i Shtetit Islamik, por udhëheqësi i përgjithshëm i myslimanëve kudo në botë.

Këto besime mund të duken si një iluzion i çmendur për shumicën prej nesh, por është e rëndësishme të kuptohet se ato janë të rënjosura teologjikisht tek islami ultra-fundamentalist. ISIS-i e sheh veten si pararojë e ushtrisë që po sjell sërish Islamin e vërtetë në botë. Ky projekt është i një rëndësie të tillë kozmike, sa ata do të thyejnë çdo numër vezësh për të bërë këtë “omëletë”, e cila është përgjegjëse për fushatën e tyre vrasëse kundër çdo grup etnik apo kombësie fetare, të cilën ata e perceptojnë se i pengon në rrugën e tyre.

Rekrutët e Shtetit Islamik gjithashtu besojnë se ne jemi në fundin e kohës, dhe se ata po e kuptojnë këtë më mirë, si anëtarë të një kulti islamik të vdekjes apokaliptike. Çfarë do të thotë kjo për politikëbërësit? Kjo do të thotë se sfidat e vërteta në këtë arsyetim duhet të vijnë nga udhëheqësit islamë dhe dijetarët, që mund ta katandisin rastin teologjik të ISIS-it, në nivelin e një lajthitjeje. Ky gjithashtu është një projekt islamik, nuk është një një projekt pune. /CNN/

Analist për Sigurinë i CNN



Nga terrorizmi ideologjik, tek terrorizmi në pragun e derës

NGA KHALED FOUAD ALLAM

Kufiri simbolik, duke mos qenë një kufi territorial, merr pjesë në procesin e globalizmit, por s'mund të jetë kundërhelmi i tij. Ajo është e keqja e tij e zezë, që e bën sot botën më të ngrysur dhe më të shqetësuar dhe që zbeh të dyja logjikat e të jetuarit së bashku: lirinë dhe barazinë

Dhuna politike është gjithmonë produkt i konteksteve historike dhe social-kulturore, të cilat ndryshojnë me kalimin e kohës. Terrorizmi i viteve '70 kishte karakteristikat e veta të tipit vertikal, me një udhëheqës, i cili vepronte në një kontekst të shenjuar nga Lufta e Ftohtë dhe konflikti midis Lindjes dhe Perëndimit, sikurse ishin Brigadat e Kuqe në Itali, Fraksioni i Ushtrisë së Kuqe në Gjermani, Ushtria e Kuqe në Japoni dhe konflikti izraelito-palestinez. Terrorizmi, që sot e përdor Islamit si një matricë politike është jashtëzakonisht përçarës, jo vetëm për shkak se ajo që e karakterizon, është tipari i saj horizontal, që e bën të vështirësisht të depërtueshëm, por edhe për shkak të rëndësisë së tij jashtëzakonisht destabilizuese. Cilado qoftë kostoja, strategjia e këtij terrorizmi që unë e quaj “në pragun e derës”, ka një qëllim: të dobësojë edhe më shumë sho-

qëritë tona dhe prishë kohezionin social që karakterizon demokracitë e sotme, në marrëdhëniet e tyre me diversitetin kulturor.

Sulmi terrorist i Parisit në 7 janar, përveç se shënoi një hap me rëndësi të madhe historike, dëshmoi faktin se konfliktet dhe dhuna politike, të krijuara nga çështja e Islamit politik, paraqesin problemin e konceptimit të botës, përcaktimin e rendit politik në një shoqëri që karakterizohet gjithnjë e më shumë nga shumëllojshmëria e përkatësisë dhe heterogjeniteti i kulturave brenda një territori të caktuar, të një territori kombëtar dhe do të thosha thuajse një perimetri kontinental, pasi kjo është një çështje që prek të gjithë Evropën dhe jo vetëm. Përse kemi aritur në këtë pikë?

Barbari përtej barbarish, që duket se na çojnë në një epokë post-mesjetare, post-moderne, në gjendje të shkurtojë distanca kulturore, përmes një përdorimi të sofistikuar të komunikimit elektronik, por në të njëjtën kohë që vret mizorisht, përmes therrjes apo vrasjes me gjakftohtësi të atyre që nuk ndajnë të njëjtin vizion mbi botën.

Çështjet e ethshme të Islamit të shekullit XXI-të: çështja e Kalifatit, marrëdhëniet midis sheriatit dhe ligjeve të shtetit, kanë përshkruar në fakt të gjithë historinë e botës arabo-islame, që nga rënia e Perandorisë Osmane në vitin 1924. Për shembull, nuk është rastësi që në 1929, viti i themelimit të “Vëllazërisë Myslimane”, një nga pretendimet kryesore të kësaj të fundit ishte lufta për rindërtimin e një kalifati jo më osman, por arab.

Ky terrorizëm i ri është pjesërisht produkt i një ndryshimi të thellë të shoqërive evropiane. Rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989, nuk pati si domethënie vetëm shembjen e bllokut sovjetik dhe ribashkimin në një të Evropës Perëndimore dhe Lindore. Por fundi i Luftës së Ftohtë ndryshoi krejtësisht paradigmat nëpërmjet të cilave në një farë kuptimi, perceptohej, apo ishte përcaktuar, pse-ja dhe si-ja e dhunës politike.

Para vitit '89, luftërat dhe dhuna politike niseshin nga një postulat: ai për të arritur, përmes barazisë dhe lirisë, një formë të caktuar universalizmi. Të njëjtat luftëra kundër kolonializmit si për shembull ajo algjeriane, i referoheshin kësaj paradigme themelore, që në thelb rridhte prej Revolucionit Francez.

Lufta për barazi, si një hap drejt universalizmit, në një farë kuptimi ka shoqëruar një pjesë të mirë të historisë së konflikteve të shekullit XX-të. Pas '89-ës, luftërat që kanë ndodhur dhe që po ndodhin deri më sot pozicionohen në një tjetër këndvështrim, një tjetër paradigmë, e cila është ajo e lindjes së kufijve simbolike dhe konflikteve etnike.

Në fakt, leximi që i bëjmë luftës në ish-Jugosllavi në vitet '90, luftës në Ruandë apo dhunës ndërmjet hinduve dhe myslimanëve në Guraxhat të Indisë, bazohet në thelb tek ajo që unë e quaj “etnizim i marrëdhënieve shoqërore”.

Ky etnizim ka ndikuar në ndërtimin e një kufiri simbolik, që mbizotëron si marrëdhëniet ndërpersonale në disa mikro-territore, ashtu edhe periferitë apo rripat urbane të qyteteve të mëdha. Kështu pati një ndryshim të rëndësishëm, një zëvendësim fetar, në vitet '90, ku ajo e Islamit u bë një nga çështjet më të rëndësishme: Islami në variantin e tij politik.

Kështu, gjuhët, kulturat, fetë bëhen shenjuese të një kundër-kulture, të një kundër-shoqërie, të botëve të dyfishta ku zhvillohet ky terrorizëm i shndërruar në terrorizmin e afërsisë. Është aty ku periferitë apo disa lagje janë të lidhura nëpërmjet internetit me një shtet, ISIS-in, që duket se ka dalë nga librat me ilustrime dhe lojërat kompjuterike.

Kufiri simbolik, duke mos qenë një kufi territorial, merr pjesë në procesin e globalizmit, por s'mund të jetë kundërhelmi i tij. Ajo është e keqja e tij e zezë, që e bën sot botën më të ngrysur dhe më të shqetësuar dhe që zbeh të dyja logjikat e të jetuarit së bashku: lirinë dhe barazinë. /“Huffpost.it”/

* *Shënim: Khaled Fouad Allam është profesor i sociologjisë së botës myslimane*



Viktimat e një rendi që po “vdes”

DAVID MILIBAND

Sistemi ndërkombëtar është i dobët dhe i përçarë. Ndonëse Lufta e Ftohtë u shenjua prej një polarizimi global, me blloqe gjeopolitike të dalluar mes tyre dhe konflikte mes të tretëve, ajo ishte gjithashtu një periudhë kur sistemi ndërkombëtar ishte më i rregullt se sa sot. Nuk duhet të vajtojmë që na iku koha e Luftës së Ftohtë; por duhet të pranojmë pasojat e zbrazëtisë që zuri vendin e saj në cerekshekullin e fundit. Sot, aftësia e botës për t'u bashkuar në një mënyrë të efektshme është thjeshtë një kujtesë e largët

Kriza e Ukrainës nuk duhet të na verbojë përballë rebusit të madh të çështjeve globale sot: ndërkohë që bota është më paqësore nga sa ka qenë për 300 vjet, kur e mat për nga numri i luftërave mes shteteve, niveli i mungesës së rendit po rritet. Në fakt ka një anarshi në rritje në pikat e nxehta të botës. Kjo tendencë mund të shihet jo vetëm në shpërthimin e brendshëm të Sirisë dhe përhapjen e konfliktit, zhvendosjeve dhe vuajtjeve të mëdha njerëzore në vendet fqinjë. Në Nigeri, vendi më i madh i Afrikës, të paktën 2500 civilë janë vrarë prej

grupit islamik terrorist Boko Haram vetëm gjatë muajit të fundit. 1.5 milion vetë janë zhvendosur në shtetet verilindorë të Yobes, Bornos dhe Adamavas, dhe dhuna u përhap më pas në Nigerin dhe Chadin fqinjë.

Veç kësaj, talebanët nuk janë zhdukur aspak nga Afganistani. Qeveria e Republikës së Afrikës Qendrore po vuan shumë për të vendosur pushtetin e saj edhe në kryeqytet. 1700 klane dhe grupe militantësh po luftojnë për pushtet në Libi. Në lindje të Kongos mbeten rreth 40 grupe të armatosur. Lista është e gjatë. Në të gjithë këta vende, në vijën e frontit është hedhur një sektor humanitar i pamjaftueshëm dhe me staf të mangët, në përpjekje për të shëruar plagët më të këqia të një numri rekord njerëzish të zhvendosur nga shtëpitë e tyre prej konfliktit dhe fatkeqësive. Agjencitë e OKB dhe OJF-të partnere të tyre kanë vështirësi shumë të mëdha për të bërë punën e tyre përballë konfliktit kaotik, kohëgjatë mes shteteve.

Ekzistojnë tre shkolla mendimi për arsyen pse po ndodh kjo. Një pikëvështrim është që, ashtu si Reformimi e shkundi Europën një gjysmë mijëvjeçari më parë, bota sot po bëhet dëshmitare e një beteje me potencial po aq shpërthyes brenda botës islamike. Pavarësisht gjithë versioneve që përmenden për rrezikun që paraqet ekstremizmi islamik për perëndimin, ia vlen të mbahet parasysh ky mendim i shprehur nga Ahmed Rashid: "ISIS nuk po bën luftë kundër Perëndimit... Kjo është mbi të gjitha një luftë brenda Islamit: një konflikt e sunitëve kundër shiitëve, por edhe një luftë nga ekstremistët sunitë kundër myslimanëve më të moderuar". Lufta brenda Islamit vendos pluralizmin përballë purifikimit. Ajo po shkatërron shtete dhe rajone, po josh njerëz të udhëtojnë në gjysmën tjetër të botës për t'iu bashkuar xhihadit, dhe po rrezikon të shkaktojë më shumë dhunë kundër myslimanëve, ashtu sikurse edhe kundër të krishterëve, hebrenjve dhe të tjerëve.

Por lufta brenda Islamit nuk është një shpjegim i kënaqshëm apo i mjaftueshëm për gjendjen e anarshisë që shohim në vende si Sudani i Jugut, 11 milionë banorët e të cilit e fituan pavarësinë vetëm pak më shumë se 3 vjet më parë. Ndonëse shteti më i ri i botës doli nga një luftë civile mes të krishterëve dhe myslimanëve, referendumi për pavarësinë mori një mbështetje 99%. Megjithatë, sot 1.5 milionë banorë të tij janë dëbuar, gjë që nuk ka aspak të bëjë me Islamin dhe ka gjithcka të bëjë me një luftë etnike për kontrollin e burimeve të vendit.

Janë të paktën edhe dy faktorë që ndihmojnë për të kutpuar krizën akute që ka mbërthyer 30 apo 40 shtete të brishtë sot. I pari është ana tjetër e monedhës së globalizimit: epoka jonë nuk është aspak e shenjuar nga homogjenizimi i popullsisë së botës apo zhdukja e dallimeve, përkundrazi, ajo është e shenjuar nga një theksim gjithnjë e më i fortë i identiteteve lokalë, etnikë, politikë dhe fetarë. Dhe një numër gjithnjë e më i madh shtetesh nuk janë në gjendje të mbajnë këta ndarje brenda kufijve paqësorë. Sistemet e tyre politikë janë shumë të brishtë, popullsitë e tyre shumë të varfëra dhe fqinjët e tyre i fusin shumë hundët, duke mos i lënë udhëheqësit e këtyre vendeve që të gjejnë mënyra për të ndarë pushtetin dhe plotësuar nevojat e njerëzve.

Por ka edhe një tjetër faktor që kontribuon për këtë ndjesi që kemi, sikur po hyjmë në një dekadë anarshie në të cilën krizat humanitare destabilizuese në shtetet e dështuar, apo ata që po dështojnë, nuk po adresohen në mënyrën e duhur. Është një faktor i lehtë të thuhet dhe i vështirë të korrigohet: Sistemi ndërkombëtar është i dobët dhe i përçarë.

Ndonëse Lufta e Ftohtë u shenjua prej një polarizimi global, me blloqe gjeopolitikë të dalluar mes tyre dhe konflikte mes të tretëve, ajo ishte gjithashtu një periudhë kur sistemi ndërkombëtar ishte më i rregullt se sa sot. Nuk duhet të vajtjmë që na iku koha e Luftës së Ftohtë; por duhet të pranojmë pasojat e zbrazëtisë që zuri vendin e saj në cerekshekullin e fundit. Sot, aftësia e botës për t'iu bashkuar në një mënyrë të efektshme është thjeshtë një kujtesë e largët.


Mendon për shpërthimin e Ebolës në Afrikë. Një reagim i ngadaltë dhe i dobët

ndërkombëtar bëri që nismat lokale të komuniteteve morën barrën më të rëndë. Si rezultat, ndërkohë që me kalimin e kohës Ebola u spraps, numri i viktimave ishte më i lartë se sa duhej.

Panorama më e gjerë na shfaq para syve institucione ndërkombëtarë që janë të rrethuar prej kërkesave të pafundme dhe prioriteteve të shteteve. Këta institucione nuk janë aspak të sigurtë në vetvete, përkundrazi ata ngërthehen gjithnjë e më shumë në pozicionet e shteteve. Bashkë me strukturat e dobëta në shtetet e brishtë, kjo është një recetë për kaos.

Spektori humanitar po punon për të përmirësuar performancën e tij në një sërë fushash, që nga sqarimi i rezultateve të ndërhyrjeve, deri tek nxitja e programimit të bazuar në prova dhe ndërhyrjet e llojit “vlëra-për-para”. Por ndërkohë që mund të përpiqemi të ngadalësojmë vdekjet, ne nuk mund të ndalim vrasjet. Kjo është një sfidë për politikën globale – një sfidë që lidhet me prioritizimin, organizimin dhe vlerat.

Marrë me autorizim nga Project Syndicate, 2015. Ripublikimi mund të bëhet vetëm me lejen e Project Syndicate – The Death Toll of a Dying Order



PROFIL / Ja se kush fshihet prapa SwissLeaks

Një takim në Paris, një javë më parë. Hervé Falciani, 42 vjec, ezmer, i veshur në mënyrë elegante shfaqet në redaksinë e Le Monde. Katër kamerat televizive do të regjistrojnë intervistën? Nuk ka problem. Specialisti francez i kompjuterëve është mësuar me vëmendjen dhe me publikun, tashmë ai ka dhënë intervista të panumërta.

Një vit më parë ai ishte kandidat për në Parlamentin Evropian, nga partia spanjolle Partido X. Temat e fushatës së tij ishin: korrupsioni dhe taksat. Megjithatë, Falciani nuk arriti të zgjidhet.

Qoftë kur flitet për HSBC dhe makinacionet e tyre të dyshimta me klientët, në këto ditë rrjedhesh informacioni për bankën zvicerane, apo qofte kur flitet për llogaritë e fshehta zvicerane të mbretërve dhe oligarkëve, të despotëve, ministrave, biznesmenëve, trafikantëve të drogës apo financuesve të al Kaedës – në qendër të çdo historie është gjithmon ky person: Hervé Falciani. “Bilbilfryrësi”. Për shumëkënd, ai është një hero. New York Times e quan “Eduard Snouden i bankave”.

Falciani pret me durim deri sa kamerat të jenë ndezur, drita të jetë në këndin e duhur dhe intervistuesja e Le Monde të jetë gati.

Historia e pabesueshme e kësaj vjedhjeje të të dhënave zë fill në mars 2006, kur Falciani transferohet nga HSBC në Monako, tek simotra e saj, HSBC në Gjene-

vë. Përpara se të hynte në botën e bankave, Falciani ishte një lojtar i apasionuar pokeri. Kishte punuar edhe tetë vjet si krupier në një kazino në Monte Karlo. Kalimi tek Banka HSBC ishte një goditje e fatit. Ne punen e re, Falciani fituar ka më shumë se 100 000 euro në vit. Misioni i tij: të krijonte një sistem të ri kompjuterik me të dhënat ekzistuese të klientëve. Pas një kohe të shkurtër, thonë ish-kolegët, Falciani ishte i pakënaqur nga puna në HSBC. Ai donte një tjetër pozicion, si dhe një sistem të ndryshëm të bazës së të dhënave.

Në cdo rast, sipas rindërtimit që kanë bërë prokurorët zviceranë, kalojnë vetëm disa muaj nga dita e fillimit të punës, deri në ditën kur, mesa duket, ai fillon të nxjerrë të dhënat konfidenciale të klientëve. Në tetor 2006, Falciani ka arritur të importojë të plotë bazën e të dhënave të klientëve të HSBC në sistemin e ri. Sipas një investigimi të brendshëm të bankës, gjatë kësaj kohe të dhënat janë nxjerrë, edhe pse ato enkriptoheshin (kodoeshin) në mënyrë të përsëritur. A mos ka qenë ky momenti kur punonjësi i pakënaqur, Hervé Falciani, pa t'i vinte në dorë shansi i artë për një të ardhme të ndritur?

Duke folur në Paris, ai sjell një version të ndryshëm. Një për të cilin kurrë nuk kishte folur deri sot: Ai pretendon se kishte patur bashkëpunëtorë. Këta – për të zbuluar mashtrimet e HSBC – kishin nxjerrë nga cloud-i (reja) të dhënat konfidenciale të klientëve, në të cilat vetë Falciani nuk kish patur asnjëherë qasje. Ai thjeshtë kishte mbledhur materialet.

Pra ai nuk ishte hajduti, vjedhjen e kishte bërë dikush tjetër. Përse e thotë këtë gjë tani? Dhe a duhet ta besojmë?

Falciani ka thënë shumë gjëra vitet e fundit, dhe shumica e tyre kanë qenë padyshim të gabuara. Në mënyrë të përsëritur ai ngatërrohet nëpër kontradikta, shpik gjëra, sjell versione të reja të historisë së tij. Edhe në këtë intervistë.

Dyshimet më të mëdha rreth besueshmërisë së tij dalin nga dëshmia e një gruaje që ka bashkëjetuar me Falcianin në periudhën 2006-2008: Georgina Mikhael, ish e dashura. Katër vjet më e re, franko-libaneze dhe e martuar, ajo u njoh me Hervé Falcianin në vitin 2006 në HSBC. Në fillim janë vetëm kolegë, më pas fillojnë një marrëdhënie dhe në fund të gjithçkaje duket se janë edhe bashkëfajtorë. Georgina Mikhael madje pretendon se Falciani kishte shkuar në HSBC Gjenevë për një arsye të vetme: të vidhte të dhënat konfidenciale të klientëve dhe të fitonte para prej tyre – gjë të cilën ai e mohon. Mikhael e përshkruan atë si manipulues dhe lakmitar. Ai në të vërtetë nuk ishte një “Robin Hood,” deklaronte ajo në gusht 2013 për New York Times.

Ndoshta në dhjetor 2006, sipas hetuesve, Falciani i ka rrëfyer të dashurës së tij një pjesë të të fshehtës. Kishte gati një projekt, me sa duket për të transferuar të dhënat që kishte vjedhur.

Për t'i shitur? Kjo është pyetja një milionë dollarëshe...

Hetuesit zviceranë i arrestojnë Falcianin dhe të dashurën e tij në dhjetor të vitit 2008 dhe i marrin në pyetje në Gjenevë. Në mbrëmje ai lejohet të largohet nga stacioni i policisë kantonale, vetëm me kusht që të nesërmen të paraqitet përsëri. Zyrtarët treguan mëshirë për të, sepse i duhej të kujdesej për fëmijën që me probleme shëndetësore. Në vend që të paraqitet përsëri në stacionin e policisë, Falciani largohet në mëngjes bashkë me familjen e tij – dhe pa të dashurën – me një makinë të marrë me qera në Nisë. Nga një server jashtë vendit ai shkarkon të dhënat e vjedhura dhe u jep pesë DVD autoriteteve franceze.

Në çështjen e ngritur kundër tij në Zvicër, pika kyçe është që Falciani donte të fitonte para me vjedhjen e të dhënave.

Ja pra, këto janë dy anët e medaljes që bota sheh sot tek Falciani: ose një turp, ose një hero.

Ndoshta ai ishte “koka e turkut” dhe në lojë ka qenë edhe dikush tjetër?

Askush nuk e di me siguri, ndoshta as ai vetë./sueddeutsche zeitung/

ANALIZA E DER SPIEGEL: Skenarët që po përgatiten në të gjithë Europën, nëse Greqia del nga Eurozona

Bankat në të gjithë Evropën, duke përfshirë Bankën Qendrore Evropiane, po përgatiten mbi mundësinë që Greqia të lërë eurozonën. Me Athinën dhe Brukselin ende në mosmarrëveshje, një skenar i tillë duket më real se kurrë. Por sa përçarëse, do...

23/02/2015

KULTURE



Asnjë surprizë, "Birdman" fluturon me 4 Oscar-ë. Dhe 8 gjëra që s'duhej t'i kishit humbur



Leksione fluturimi: Rilindja e çuditshme e Michael Keatonit



Regjisori i "Birdman": Kështu e sfidoj Hollywoodin

SOT NE BOTE



"Izraeli gënjeu për armën bërthamore iraniane". Ja dokumentat e Mossadit

23/02/2015

Dokumentat që ka siguruar Al Jazeera tregojnë se shërbimi i fshehtë izraelit ishte i një



Gjermania rikthen "Mein Kampf"-in e Hitlerit vitin tjetër

23/02/2015

Luka Hurst "Newsweek" Autobiografia e Hitlerit 'Mein Kampf' (Lufta ime), do të



Kim Jong i kërkon ushtrisë të përgatitet për luftë

23/02/2015

Në fjalimin para Komisionit Qendror Usharak, Kim Jong-un ka kërkuar nga Komanda e Ushtrisë



Greqia dërgon në Bruksel një listë të parë me reforma

22/02/2015

Greqia ka dërguar në Bruksel një listë të parë me reforma, për t'i hapur rrugë konfirmimit



John McCain për Amerikën: Më vjen turp nga vendi im

23/02/2015

"Më vjen turp nga vendi im, më vjen turp nga presidenti im dhe më vjen turp nga vetja që nuk



Rebelët thonë se po tërheqin armët. Por Kiev akuzon: Po hyjnë tanke rusë

22/02/2015

Rebelët filorusë në Ukrainën lindore konfirmojnë tërheqjen e artillerisë së rëndë nga vijat

OFERTË NGA SPITALI AMERIKAN



Për një vit të ri të shëndetshëm, kujdesuni për zemrën tuaj.

- Vizitë Kardiologu
- EKG
- Echo Zemra
- Provë Ushtrimore
- Lipidogramë

5000 Lekë



Spitali Amerikan

042 35 75 35

www.spitaliamerikan.com

ZDRITJE